

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, nr. 111, korrik – dhjetor 2023
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter Hysaj
Ky numër u sponsortizua nga: **Afërdita Breshanaj (Hysaj)**



FSHATI KALLARAT NË DEFTERËT OSMANË TË VITEVE 1551 E 1583

Megjithëse Kallarat është gati një mijëvjeçar, Memri i tij dëshmohet për herë të parë më 1432, në Deferin osman të tokave të sanxhakut të Shqipërisë dhe pastaj në defterët e mëvonshëm, që hartoheshin sa herë kishte ndryshime të ndarjes administrative të Shqipërisë në kaza e sanxhaqe. Vite më parë, prof. Petrika Thëngjilli (studiuues i periudhës osmane që tani jeton në Itali), më pat dhënë një fotokopje të fletëve për kazanë e Kurveleshit nga Deferi i vitit 1583 i sanxhakut të Delvinës. Meqenëse për shkak të problemeve me shikimin prof. Thëngjilli nuk mundi të më ndihmonte me përkthimin...

Faqe 3



KRONIKË E NJË FSHATI QË PO RINGJALLET



Faqe 8

NDËRGJEGJËSIMI I KALLARATASVE PARA TAKIMIT TË BREZAVE



Faqe 3-6

20 TETOR 1916 - 20 TETOR
2023, 107-VJETORI
I ÇELJESË SHKOLLËS
SË PARË SHQIPE
NË KALLARAT

SHIFRA DHE FAKTE HISTORIKE
PËR ARSIMIN NË KALLARAT




Fshati Kallarati ka historinë e tij shumëvjeçare të qëndresës e të luftës ndaj pushtuesve të huaj, por edhe atë të ndërtimit dhe të lulëzimit të tij në vitet e pasluftës dhe në ditët e sotme të demokracisë. Një pjesë e historisë së tij lidhet ngushtë me kontributin që ka dhënë...

Faqe 14

HYSO XHAFERAJ, ZËRI
I NDËRPRERË I KËNGËS, NGA
CIKLI "VISARE TRASHËGIMIE" I
STUDIUESIT TË FOLKLORIT
SEJMEN GJOKOLI

Faqe 15

FSHATI KALLARAT NË DEFTERËT OSMANË TË VITEVE 1551 E 1583



NGA PROF. DR. RAMI MEMUSHAJ

Megjithëse Kallarati është gati njëmijëvjeçar, emri i tij dëshmohe për herë të parë më 1432, në Defterin osman të tokave të sanxhakut të Shqipërisë dhe pastaj në defterët e mëvonshëm, që hartoheshin sa herë kishte ndryshime të ndarjes administrative të Shqipërisë në kaza e sanxhaqe. Vite më parë, prof. Petrika Thëngjilli (studiuues i periudhës osmane që tani jeton në Itali), më pat dhënë një fotokopje të fletëve për kazanë e Kurveleshit nga Defteri i vitit 1583 i sanxhakut të Delvinës. Meqenëse për shkak të problemeve me shikimin prof. Thëngjilli nuk mundi të më ndihmonte me përkthimin e tyre, iu drejtova për ndihmë historianit osmanist Ferid Duka për të më përkthyer pjesën e Kallararit. Profesor Duka, me gjithë detyrimet e veta pedagogjike e shkencore, gjeti kohë për të m'i përkthyer jo vetëm emrat e taksapaguesve të Kallararit në regjistrin e vitit 1583, por edhe në regjistrin e vitit 1551. Për këto i jam shumë mirënjohës.

Ndryshe nga Defteri i vitit 1432, që jep vetëm numrin e familjeve, në këta dy defterë, që nuk besoj të jenë të vetmit, jepen emrat e personave të tatuar. Në të dy regjistrat taksapaguesit ndahen në kryefamiljarë e beqarë, po me dallimin që në regjistrin e vitit 1551 shënohen cilët ishin beqarë (të pamartuar apo vejanë që numëroheshin si shtëpi më vete). Lista e emrave i bën shumë interesantë këta defterë, pasi në ta mund të kërkojmë katragjyshërit tanë. Sipas studiuësve të këtyre regjistrave, shumica e individëve janë regjistruar me emrin e tyre dhe me emrin e babait. Kjo është një traditë që ka vazhduar deri në shekullin e njëzetë. Kështu, kemi Barjam Qamili, Muço Xheviti, Nazo Murati, Ruzhdi Lame, Sulo Nexhipi etj., ku emri i dytë është emri i babait. Si shembuj emrash me tri pjesë janë Memush Balil Memushaj e Veip Balil Memushaj, ku Balili është babai, kurse Memushi është gjyshi. Pra, më shumë të ngjarë ka që në këta defterë emri i dytë të jetë emri i babait. Megjithatë, raste si emri Bezhani, që e mbajnë si pjesë të dytë 9 veta (Duka, Gjoni, Gjoni, Gjoni, Nika, Nika, Nika, Nika dhe Thanasi), dëshmojnë që Bezhani nuk është emri babait, po mbiemri, pasi një baba nuk mund t'i quante 3 djem me emrin Gjoni dhe katër të tjerë Nikë; po kështu edhe me emrat e dytë Gjoni (1551 e 1583) dhe Andria, Kosta, Menkshi e Nika më 1583. Edhe prof. F. Duka mendon që emri i dytë është llagap, përndryshe, në defter do të ishte shkruar, p.sh. Gjergji i biri i Todrit dhe jo Gjergji Todri. Gjithsesi, kjo është punë e historianëve që merren me studimin e asaj periudhe. Për shkak të kësaj pasigurie, po edhe të largësisë në kohë (4 shekuj e gjysmë), çdo lidhje midis këtyre emrave dhe fiseve të sotme është e dyshimtë. Të dhënat e këtyre defterëve janë shumë të rëndësishme për historinë e fshatit tonë. Së pari, të gjithë kryefamiljarët janë të krishterë, si më 1551, edhe më 1583, pra edhe pas 150 vjet pushtimit Kallarati mbetej një fshat 100% i krishterë. Kjo del jo vetëm nga këqyrja e emrave, po edhe nga taksat e ispenxhës (taksat për rajatë e krishterë), që ishte 25 akçe për familje. 2050 akçet që shënohen në defterin e vitit 1551 i paguanin 82 familje, pra të gjitha familjet ishin të krishtera. Më 1583 kjo taksë ishte 2100 akçe, që i bie të paguanin 84 familje, pra dy familje nuk e paguanin. Po a ishin këto dy familje myslimane? Nga emrat nuk duket të ketë të tilla.

Së dyti, pothuajse të gjithë emrat janë të traditës kishtare shqiptare, që në shekujt e parë pas ndarjes së kishës së krishterë në katolikë dhe ortodoksë më 1054 ka qenë më afër katolicizmit se ortodoksisë. Kështu që nuk ka emra ortodoksë në trajtën greke, me përjashtim të Andrea, Jani e ndonjë tjetër. Kjo tregon se në shekullin e gjashtëmbëdhjetë në Labërinë e brendshme ndikimi i kishës ortodokse të Bizantit, që i greqizon emrat e përveçëm, ishte pothuajse zero.

Së treti, po të pranojmë se emrat e dytë janë llagape, del se ka lëvizje të popullsisë. Kështu, më 1583 nuk dalin më llagapet Çaqi, Deda, Golemi, Llazari, Masha, Mekshi, Mërtiri, Qesari, Strata, Toma e Varfi; por dalin llagapet Çani, Gjergji, Jani, Komini, Nase, Pëllumi, Sava, Thanasi, Throni, e Varo, çka do të thotë se në 30 vjet lëvizjet janë të dukshme. Sidoqoftë, këtu jemi të pasigurt, për arsye që parashtruan në paragrafin e mësipërm.

Me rëndësi janë të dhënat e këtyre dy defterëve për pasuritë e fshatit dhe për kulturat bujqësore të tij. Në këta regjistra del se Kallarati kishte tre mullinj, për të cilët në defterin e parë thuhet se ishin "gjysmëvjetorë". Besojmë se janë tre mullinj që njohim edhe sot: mulliri i Bodeit e mulliri i Toçe, që punonin gjatë periudhës së shirave, dhe mulliri i Lëmëplakut, që

punonte gjatë verës. Fshati rriste derra dhe mbante bletë (po çuditërisht nuk përmenden bagëtite e trasha dhe të imëta, veç derrave); mbillte grurë (misri në Europën Jugore hyri nga Spanja në shekullin e shtatëmbëdhjetë), elb, mel, bathë, thjerrëza dhe perime; kishte hardhi dhe ndoshta edhe vreshta, përdërisa detyrohej të paguante çdo vit 200 medre musht (1 medre = 4 okë, ose 5,131 litra), dmth. 1026 litra musht!

Siç kemi shkruar edhe te "Histori e Kurveleshit", taksat që mernte pushtuesi ishin të papërbalueshme. Kështu, më 1551 fshati detyrohej të paguante 13.985 akçe (baras me 9 kg e 230 g argjend), që i binte mesatarisht 170,56 akçe për familje. 32 vjet më vonë, më 1583, fshati duhej të paguante 13.700 akçe, dmth. rreth 160 akçe për familje, me një ulje të vogël në krahasim me vitin 1551.

Se sa të rënda ishin këto taksat, kjo kuptohet, po të kemi parasysh që si taksë merrej një e dhjeta e prodhimit vjetor. Nuk mund të besohet që më 1551 Kallarati të prodhonte 2.300 barrë drithëra (1 barrë = 153,95 kg), pra 3.542 kv, 2.000 medre musht (10.262 litra), të kishte aq shumë zgjoje e derra; apo më 1583 të prodhonte 2.100 barrë drithëra (3.234 kv), 2.000 barrë musht etj. Këto tatime shumë të rënda ishin arsyeja pse popullsia hidhej në kryengritje të herëpashershme.

Kallarati në regjistrat osmanë

1. Defter-i mufassal-i liva-i Delvina (Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Delvinës), nr. 273, viti 1551

Fshati Kallogjerat (ose: Kallogjerân), varet nga e përmendura (nahija e Kurveleshit); timar i ushtarëve beshlinj (merrnin 5 akçe në ditë) të kalasë së përmendur (kalasë së Nivicës) Nika Bezhani, Thanas Bezhani, Nika Bezhani, Gjoni Bezhani, Qesar Gjoni, Duka Qesari, Martin Llaqi, Nika Llaqi, Toma Llaqi, Toma Llazari, Gjoni Masha, Gjoni Kondi, Menksh Gjoni, Kond Nasta, Martin Gjini, Gjoni Varfi, Gjergji Todri, Gjoni Zhupa, Duka Zhupa, Andria Zhupa, Toma Andria, Duka Toma, Martin Gjini, Menksh Kondi, Martin Menkshi, Martin Golemi, Gjoni Golemi, Meksh Golemi, Andre Gjoni, Gjini Mekshi, Gjini Mekshi, Golem Mekshi, Duka Asti, Martin (I)Strata, Gjoni (I)Strata, Ason Llaqi, Toma Gjini, Gjini Toma, Poloni (Pullumi?) Toma, Gjini Gjoni, Gjini Toma, Gjini Varfi, Poloni Zhupa, Gjoni Martini, Deda Martini, Gjoni Duka, Martin Duka, Kond Duka, Bezhani Duka, Gjoni Bezhani, Nika Bezhani, Duka Bezhani, Kond Gjini, Gjoni Gjini, Andria Gjoni, Andria Nika, Duka Mërtire, Hila Martini, Llaq Kosta, Gjoni Bezhani, Nika Bezhani, Nika Kosta, Zhupa Nika, Andria Zhupa, Duka Nika, Gjoni (Gjini?) Nika, Toma Nasta, Kosta Andria, Deda Nika, Gjini Çaqi, Andria Toma, Kosta Gjoni, Llaqi Gjoni, Llaqi Thanasi (beqar), Stoja Kosta (b), Nika Gjoni (b), Qesar Toma (b), Toma Qesari (b), Andria Kondi (b), Gjoni Todri (b), Gjini Zhupa (b), Golem Menkshi (b).

Taksapagues – 82

Shtëpi – 73, beqarë – 9

Tatimet në akçe:

Ispenxha – 2.050; grurë – barrë: 110, vlera: 4.840; elb – barrë: 60, vlera: 1.680; mel – barrë: 50, vlera: 1.400; bathë dhe thjerrëza – barrë: 10, vlera: 440; musht – medre: 200, vlera: 2.400; e dhjeta e zgjoit – 290; taksat e derrave – 269; taksat e barit – 365; taksat e perimeve – 146; mullinj (gjysmëvjetorë) – njësi: 3, taksat: 45; badihavaja, taksat e martesës, gjopa për krime, pula dhe të tjera – 100.

Shuma – 13.985 akçe

(faqja 248 e Defterit)

2. Defter-i mufassal-i liva-i Delvina (Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Delvinës), nr. 91, viti 1583

Fshati Kallogjerat (ose: Kallogjerân), varet nga Kurveleshi (nahija)

Kond Gjini, Brat Gjini, Kond Duka, Nika Duka, Kosta Nika, Gjoni Nika, Kond Nika, Vllaq Andria, Vllash Martini, Gjoni Martini, Gjoni Thanasi, Gjini Nika, Thanas Throni (Garuni, Aroni, Merushi, Mirushi?), Marin (Kurtes, Meris, Mertes?) Nika, Thron Gjergji, Gjika Sava, Gjoni Nika, Gjoka Andria, Duka Gjoni Varfi, Martin Kosta, Nika Zhupa, Gjoni Kosta, Zhupa Nika, Andria Nika, Duka Nika, Kond Andria, Kond Gjini Menkshi, Gjini Menkshi, (faqja 73/a e Defterit)

Kond Menksh Martini, Golem Menkshi, Martin Menkshi, Gjika Nika, Thanas Nika, Tupe Nika, Duka Bezhani, Zhupa Menkshi, Qesar Menkshi, Zhupa Llaqi, Gjoka Andria, Deda Nika, Martin Jani, Gjoni Çani, Gjoka Gjergji, Gjoni Todri, Gjini Nase (Tase?), Tusha (Tupe?) Nase Gjini, Kond Duka Gjoni, Martin Gjoni Duka, Gjoka Kondi, Kond Bezhani, Martin Kondi, Gjini Asti, Nika Tupe, Kond Kosta, Menksh Kosta, Bezhani Kosta, Duka Kosta, Thanas Tusha (Tupe?), Gjini Duka, Nase Gjoni, Gjini Pëllumi, Andria Tusha (Tupe?), Deda Tusha (Tupe?), Nika Komini, Tusha (Tupe?) Gjini, Progan Gjini, Nika Llaqi, Kond Varo, Duka Andria, Tusha (Tupe?) Andria, Kond Gjoni, Mesir Gjoni, Gjini Zhupa, Zhupa Gjoni, Nikolla Gjoni, Bezhani Martini, Nika Thanasi, Llaq Menksh Gjoni, Gjini Duka, Gjergji Gjoni, Gjoni Llaqi, Duka Kosta, Tusha (Tupe?) Nika, Zhupa Tusha (Tupe?), Tusha Nika, Gjoni Martini.

Kryefamiljarë – 86

Shtëpi – 80, beqarë – 6

Tatimet në akçe:

Ispenxha – 2.100; Grurë – barrë: 50; vlera: 2.250; elb – 100; vlera: 2.900; mel – barrë: 50; vlera: 1.450; bathë, qiçra dhe bizele – barrë: 10; vlera: 450; e dhjeta e mushtit – medre: 200; vlera: 2.400; e dhjeta e zgjoit – 400; mullinj – njësi: 3; taksat: 45; taksat e barit – 100; taksat e perimeve – 200; taksat e derrave – 170; badihavaja, taksat e martesës dhe të tjera sipas vendimit të mëparshëm – 600.

Shuma – 13700 akçe

(faqja 73/b e Defterit)

Shënim:

Para emrave që fillojnë me dy bashkëtingëllore, shkruasi ka shtuar një i, të cilën përkthyesi e ka vënë në kllapa. Kjo zanore është shtuar për të lehtësuar shqiptimin në osmanishte, në të cilën nuk kishte fjalë që të nisnin me dy bashkëtingëllore. Pra, (I)Strata, është Strata.



MË 12 GUSHT 2023 NË KALLARAT U ZHVILLUA TAKIMI I BREZAVE
(Mbresa, përshtypje, falënderime)

NDËRGJEGJËSIMI I KALLARATASVE PARA TAKIMIT TË BREZAVE

Të dashur bashkëshatarë kallaratas!

Ashtu siç kemi krijuar traditën, por edhe njoftuar kohë më parë, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” në bashkëpunim me Kryesinë e Fshatit, më 12 gusht 2023 organizojnë në Kallarat “Takimin e Brezave”. Janë të lutur për të marrë pjesë banorët e fshatit dhe gjithë kallaratasit e tjerë lindur ose me origjinë nga Kallarati, kudo që ndodhen, brenda e jashtë vendit, si dhe kushdo tjetër që ka lidhje familjare, miqësore e shoqërore me kallaratasit.

Për herë të parë në këtë takim do të kemi këngëtarën e mirënjohur të muzikës popullore, Maja (Maya) Aliçkaj, këngëtarën korçare Ermira Kola (Strati), si dhe këngëtarin kallaratas Gjergj Leskaj, i përhershëm në ngjarje të tilla. Takimi do të moderohet dhe filmohet nga ekipi i emisionit “Autokton” të News 24, nga gazetarja e njohur Anila Ahmataj, regjisori dhe kameramani, Ardit Zotaj dhe montazhieri Erti Ahmataj.

Takimi i brezave fillon në orën 19:30 dhe do të vijojë pa mbarim deri në orët e vona. Mos humbisni kohë, por planifikojeni për të qenë të pranishëm, për të kaluar së bashku një natë të magjishme me këngë e valle popullore nën tingujt e një orkestre të zgjedhur dhe të këngëtarëve të talentuar, shoqëruar me ushqimin tradicional mish “bio”



12 GUSHT 2023

“TAKIMI I BREZAVE” NË KALLARAT





M
a
y
a

Maya!

Mirë se erdhët në
Kallarat!

Ju këndostë shpirti
dhe zemra!



Sponsorizoi firma:



të pjekur në hell, prodhime e gatime të bashkëshatarë që, me sponsorizohet e veçantë të këtij takimi, aq më tepër praninë e tjera të fshatit. Falënderojmë të gjithë ata bëra, do të mundësojnë organizimin e këngëtarëve, të orkestrës dhe të fonisë.

KRYESIA E FSHATIT DHE KRYESIA E SHOQATËS "KALLARATI"

BESIM I PLOTË PËR NJË TAKIM
BREZASH TË SUKSESSHËM

Grupi organizator i takimit të brezave, si asnjëherë tjetër, shpreson se takimi i brezave i këtij viti do të jetë më i arritur. Pse?

Së pari. Pritet që pjesëmarrja të jetë e madhe, sepse njoftimi për datën 12 gusht është caktuar dhe hedhur në rrjetet sociale që në fillim të vitit, duke i krijuar kujtudo mundësinë e planifikimit të lejeve, sidomos të emigrantëve. Veç vendësve, pritët që në takim të vijnë edhe nga fshatrat fqinjë.

Së dyti. Pjesëmarrja për herë të parë e një këngëtareje të madhe, siç është Maja (Maya) Aliçkaj, këngëtares tjetër të njohur të serenatave korçare Ermira Kola (Strati), por edhe e këngëtarit kallaratas Gjergj Leskaj do ta bëjë këtë takim shumë tërheqës.

Së treti. Për herë të parë ky takim do të moderohet nga gazetarja me përvojë e TV "News 24" dhe e emisionit "Autokton" e "Me zemër të hapur" znj. Anila Ahmataj dhe do të filmohet me një teknologji të re, përfshi edhe dron, nga z. Ardi Zotaj, regjisor i emisionit "Autokton", si dhe montazhi i videos do të bëhet nga një tjetër profesionist i po këtij emisioni, z. Erti Ahmataj, tashmë i



njohur në Kallarati për emisionin për Bilbilin e Labërisë Hyso Xhaferaj dhe në ceremoninë përkujtimore në "Fshatin e Djegur" më 7 maj 2023, në kujtim të dëshmorëve të vitit 1914.

Së katërti. Angazhimi dhe bashkëpunimi për këtë takim brezash i Këshillit të Fshatit, Kryesisë së Shoqatës dhe i vetë banorëve kallaratas ka qenë më mirë se asnjëherë tjetër.

Së pesti. Sponsorizimi i biznesmenëve dhe djemve të Kallaratis për këngëtarët, orkestrën, filmimin dhe aspekte të tjera, ka qenë më mirë se çdo herë tjetër. Janë pikërisht zgjedhjet e tyre për pjesëmarrjen e personaliteteve të tilla të muzikës, artit e kulturës.

Së gjashti. Punonjësit e klubeve si gjithmonë janë angazhuar për të pritur njerëzit e ardhur në mënyrën më të mirë të mundshme, me ushqime e gatime tradicionale. Të gjitha këto na shtojnë shpresën e besimin se do të kemi një "Takim Brezash" të veçantë.

CILËT JANË KËNGËTARËT NË
TAKIMIN E BREZAVE NË KALLARAT
MË 12 GUSHT 2023 NË MBRËMJE?

*E FTUARA SPECIALE, KËNGËTARJA E MUZIKËS POPULLORE,
MAJA (MAYA) ALIÇKAJ*

Maja Aliçkaj është këngëtare e njohur. Ajo e kaloi fëmijërinë dhe mori formimin e parë arsimor në Dukat. Që në këtë moshë, Maja spikati me talentin e saj të lirshëm dhe origjinalitetin e saj në imitime, personifikime personazhesh etj. dhe pjesëmarrjes në koncerte të ndryshme me këngë për fëmijë, si një shenjë e dukshme e asaj rrugë dhe ëndrrë që ajo do të realizonte më pas. Pas përfundimit të shkollës së mesme të përgjithshme në Vlorë, ajo konkurroi dhe fitoi audicionin e Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë, një ëndërr e saj e gjatë që në fund u bë realitet. Studioi për 5 vjet në këtë Akademi, ku më pas u diplomua si aktore. Me përfundimin e studimeve, nisin dhe angazhimet e saj profesionale në fushën e artit, duke nisur fillimisht punën si asistent-pedagoge pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë dhe njëherazi gjatë kësaj periudhe edhe si asistente e regjisorit Rikard Ljarja, me të cilin vë në skenë Lisistratën. Krahas asistimit me regjinë, në këtë pjesë teatrale ajo luan edhe vetë një rol. Gjithashtu, ajo ka qenë protagoniste në filmin "Zemra e Nënës", me rolin e personazhit Ana. Edhe në Teatrin Kombëtar nuk ka munguar interpretimi i saj në role të ndryshme. Më pas, Maya largohet nga Shqipëria për në Gjermani, pas ftesës së mikeshës së saj gjermane për të vizituar si turiste këtë vend. Por, nga një vizite turistike, kjo ikje do të shënonte një fazë të re në jetën e saj. Fillon kështu në Gjermani një jetë tjetër, ku shpesh, shumë gjëra, i është dashur t'i nisë nga e para. Studioi në Universitetin e Vupertalit për histori e filozofi. Gjithashtu, duke mos dashur të shkëputet nga profesioni i aktrimit, angazhohet gjatë kësaj periudhe në teatrin gjerman, ku luan role të ndryshme, si në "Tic Teatër", një rol në filmin "Einzats fur Elrich", në programin televiziv RTL etj. Paralelisht me këto zotime, gjatë këtyre viteve, ajo nuk mund të linte pas dore edhe këngën, si një pasion i hershëm që në fëmijërinë e saj. Në këtë mënyrë, ajo angazhohet në shumë koncerte në disa vende të Europës, si në Gjermani, Austri, Zvicër, Holandë, Bruksel, Londër, Itali, Greqi etj. Gjatë



qëndrimin në Gjermani, Maja bëhet gjithashtu pjesë e një CD-je ndërkombëtare të hedhur në treg në Gjermani me këngë të këngëtarëve nga vende të ndryshme. Në këtë CD janë përfshirë 4 këngë të sajat në shqip.

Veçantia e krijimtarisë muzikore të Majës,

krahas talentit dhe zërit të saj, është se në rreth 80 për qind të kësaj krijimtarie, këngët mbajnë vulën e saj në muzikë e tekste. Maja u shpreh mirënjohjen e madhe bashkëpunëtorëve të saj në rrugën e muzikës, veçanërisht kompozitorit të mirënjohur shqiptar Adrian Hila, me të cilin

ka realizuar të gjitha këngët dhe suksesin e saj, Shtëpisë diskografike "Elrodi Music", që menaxhon krijimtarinë e saj në treg, "Max Production" për realizimin e klipëve etj.

E pakënaqur asnjëherë tërësisht me atë që bën, këmbëngulëse, kërkuese dhe kritike e madhe e vetes, gjithmonë në kërkim të gjërave të veçanta dhe origjinale në muzikë, modeste deri në teprim përballë publikut të saj, Maja vazhdon të mendojë se i duhet ende shumë punë për ta merituar vërtet gjithë këtë respekt dhe admirim të publikut.

Gjatë karrierës së saj artistike, Maja ka nxjerr në treg një sërë videoklipesh me këngë popullore shumë të pëlqyeshme për mbarë publikun. Gjithashtu, Maja është e kërkuar dhe e pranishme në një sërë koncertesh të diasporës.

KËNGËTARJA KORÇARE ERMIRA KOLA (STRATI)

Ermira Kola (Strati) është hera e parë që vjen në fshatin e origjinës së bashkëshortit të saj, avokatit Besnik Strati, dhe ka shprehur dëshirën për të përshëndetur pjesëmarrësit me këngë nga repertori i saj.

Po kush është këngëtarja korçare Ermira Kola? Ermira është këngëtare e njohur. Me zërin e ngrohtë dhe të thellë, ajo të sjell ndër mend serenatat korçare, të cilave u ka qëndruar gjithnjë besnike. Prej disa vitesh ajo ka pasur një tërheqje nga daljet mediatike. E ftuar në studion e "Rudina" në Tv Klan, ajo foli për marrëdhënien me muzikën, por edhe për familjen, sepse është bërë nënë e një djal. Gjatë emisionit këngëtarja rrëfeu historinë e dashurisë me bashkëshortin e saj Besnikun. "Unë dhe Besniku kemi 13 vjet bashkë. Jemi njohur në biznesin e tij, ku unë punoja. Aty u dashuroam. Në ato vite unë merresha vetëm me koncerte e festa dhe e paragjykoja punën në një lokal. Po pikërisht aty nisa të punoja. Filllova të ndërtoja jetën në Tiranë. Aty njoha edhe dashurinë time të jetës. Me artistët është pak e vështirë, nuk është kollaj të gjes dikë që të të kuptojë dhe të të mbështetë. Fati e solli këtë njeri atje ku nuk e prisja. Ne ishim gjatë gjithë kohës bashkë dhe vendimi ynë erdhi në një moshë të pjekur. Bëmë një ceremoni fejese dhe pas tre muajsh u martuam, s'kishim çfarë të prisim sepse ne bashkëjetonim. Ne të dy e donim një dasmë. Unë kam kënduar në dasmën time, me mua ka kënduar edhe bashkëshorti im. Pas meje u ngritën të gjithë dhe kënduan, u bë show aty. Të ftuar në dasmën tonë kanë qenë 400 veta në dasmën e bashkëshortit dhe 300 tek dasma ime. Ne kemi 8 vjet të martuar dhe pas këtyre 8 vjetëve erdhi në



jetë Xhoni", rrëfeu këngëtarja Ermira Kola.

Në dhjetor 2004, Ermira Kola e Kozma Dushi marrin pjesë në Festivalin e 43-të në RTSH me këngën "Të bashkëjetoj me ty"; në prill 2006 merr pjesë në Top Fest 3 me

këngën "Më ke një borxh"; në vitin 2006 publikon albumin "Cim Cim Ca"; në maj 2010 merr pjesë në "Netët e Klipit Shqiptar" me këngën "Pranë teje një jetë"; më 11 maj 2013 Ermira publikon videoklipin "Kolazh

me serenata korçare"; në nëntor 2013 merr pjesë në "Musical-Fest 2013" me këngën "E mjera po qaj me lot"; dhe në mars 2014 merr pjesë në "Kënga ime 2014" me këngët "Të dalë ku të dalë" dhe "Bjondina".



KËNGËTARI I MUZIKËS POPULLORE, GJERGJ LESKAJ

Përveç këngëtares së njohur Maja Aliçkaj dhe Ermira Kola, si gjithmonë në takime të tilla të organizuara nga shoqata, do të jetë edhe djali kallarrat Gjergj Leskaj.

Gjergji është një këngëtar i njohur i këngës labe, në rolin e marrësit, jo vetëm në Kallarat, por pjesëmarrës edhe në disa grupe labe të dëgjura në Tiranë. Por kohët e fundit, muzika ku identifikohet më shumë, është ajo popullore e Shqipërisë së Jugut. Në vitin 2012, Gjergji publikon albumin "Unë jam bir nga Labëria". Në mars 2022 publikon videoklipin "Xhaxhai". Muzika dhe orkestrimi i këngës janë punuar nga Alban Hoxhaj.

Ndërmjet të tjerash, në repertorin e tij muzikor përfshihen këngët: "Jam bir nga Labëria", "Moj Eleni", "Vajzat e Hoxhës", "Bijtë e Shqipërisë", "Babai", "Do t'ia marrim këngës", "Qengji i urtë pi dy nëna", "Xhaxhai" etj.

SI U ZHVILLUA TAKIMI I BREZAVE?

Ashtu siç ishte planifikuar, më 12 gusht 2023 në Kallarat i zhvillua Takimi i Brezave. Mund të themi me plot gojën që në fillim të këtij shkrimi se ky takim ishte një nga takimet më të arrira të këtyre viteve të fundit. Takimi u moderua në mënyrë të shkëlqyer nga gazetaria Anila Ahmataj.

Fillimisht ekzekutohet Himni Kombëtar i Republikës së Shqipërisë.



Moderatorja: Mirëmbërëma të gjithëve! Mirëmbërëma Kallaratit! Është kënaqësi që sonte, në këtë mbrëmje të magjishme, së bashku me stafin tim të emisionit "Autokton", Ardi Zotaj e Erti Ahmataj, të ndodhem në Kallarat, mes banorëve të këtij fshati mikpritës e me tradita të lashta historike, patriotike e kulturore. Faleminderit drejtuesve të Shoqatës, që na bënë pjesë të këtij eventit dhe më besuan mua si gazetare ta moderoj këtë takim brezash. Kam besim se së bashku do ta kalojmë këtë natë të veçantë në mënyrë më të gëzueshme. Të dashur banorë të Kallaratit, ju që jetoni e punoni përgjithmonë në këtë fshat të bukur! Mirë se ju gjetëm! Mirë se erdhët në këtë mbrëmje, të gjithë ju që banoni diku tjetër, por keni lindur e rritur këtu ose jeni me origjinë prej këtij fshati të bukur me kulturë e tradita! Mirë se erdhët të gjithë ju të rinj e të reja, nipër e stërnipër të këtij fshati, që ruani si gjënë më të shtrenjtë dashurinë për origjinën e prindërve dhe gjyshërve tuaj dhe respektin ndaj tyre!

Mirë se erdhët ju emigrantë, që edhe



pse jetoni e punoni jashtë vendit, në Greqi, Itali e vende të tjera, shpirtin e zemrën e keni pikërisht këtu, në atdheun tuaj, në fshatin tuaj, Kallaratit!

Por, me sa jam në dijeni, këtu ka edhe mjaft pjesëmarrës jokallarratas, por që diçka tjetër i lidh me këtë fshat, miqësia e shoqëria, ashtu siç ka edhe mjaft të ardhur nga fshatrat fqinje, Bolena, Kuçi e Vranishti. Mirë se keni ardhur edhe ju dhe le të festojmë së bashku.

Kam ditë që kam ndjekur publicitetin që i është bërë këtij takimi në rrjete sociale, "Do vijë Maja, do vijë Ermira, do vijë Gjergji, do vijë Anila, do vijë..." dhe mendoja: Vërtet kaq bukur dinë kallarratasit të organizojnë takimet e brezave! Por tani bindem se kjo pjesëmarrje dhe ky organizim i grupit drejtues të takimit nuk më ka zhgënjyer.

Prandaj ju ftoj për një duartrokitje për grupin organizues të Shoqatës dhe këshillin të fshatit, që ideuan këtë takim kaq të bukur, dhe, në mënyrë të veçantë, për të gjithë ata që kontribuuan financiarisht, materialisht dhe në formë të tjera.

PËRSHËNDETJA E MIRËSEARDHJES NGA KRYETARI I FSHATIT Z. LEFTER QEJVANAJ

Të nderuar pjesëmarrës!

Jam i privilegjuar që në këtë natë magjike në emër të gjithë banorëve të fshatit t'ju uroj mirëseardhjen juve bashkëfshatarëve të larguar, miqve e dashamirësve nga Kuçi, Vranishti e gjetkë për të kaluar së bashku momente mbresëlënëse nën tingujt e këngëve e valleve, që do të na shoqërojnë gjatë gjithë natës duke shijuar mishin e pjekur dhe gatimet tradicionale BIO. Këngëtarët e mrekullueshëm Maja Aličkaj, Ermira Kola dhe bashkëfshatari ynë Gjergj Leskaj do të jenë sonte qershia mbi tortë e kësaj mbrëmjeje.

Pjesëmarrës të nderuar! Fshati ynë ka një pozicion të mrekullueshëm në këtë luginë fantastike, me një shesh që rrallë fshat e ka, por ka edhe një histori të gjallë, që janë rrënojat e Fshatit të Djegur, të cilat flasin vetë për të kaluarën e tij. Ndaj ju kërkoj që, për ta mbajtur gjallë shpirtin patriotik, të shpallim të dielën e dytë të muajit maj ditë pelegrinazhi, aty ku gati 110 vjet më parë gjyshërit tanë u përlëshën me andartët grekë, që e shkumbua fshatin të tërin. Kjo edhe si promovim i sezonit turistik, duke shpresuar që dhe bashkia të kthejë syrin edhe nga ne. Meqë na u dha rasti, siç jeni në dijeni, lugina e Shushicës është shpallur zonë e mbrojtur në krah të basenit të Vjosës dhe çuditërisht kryhen punime për devijimin e ujit të saj drejt Himarës për ujë të pishëm, por, nga sa po dëgjojmë, mund të ndërtohen edhe 2 HECE me këtë ujë po në Himarë. Kjo është një pabesi që na bëhet ne dhe krejt komunitetit, që e ka lidhur jetën e tij me këtë lumë.

Uroj të kalojmë këtë natë sa më këndshëm!

Ju faleminderit.



FJALA E RASTIT NË EMËR TË KRYESISË SË SHOQATËS NGA SEKRETARI I SAJ HASAN MEHMETAJ

Sekretari i Shoqatës Kallarati, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në emër të kryesisë së Shoqatës, uroi mirëseardhjen dhe një mbrëmje të bukur mes familjarëve të tyre, miqve e shokëve dhe u uroi atyre "Gëzuar festën!"

Më tej, Hasani u shpreh: "Guri i rëndë peshon në vendin e vet, ndaj edhe sheshi i Morrezës e ndien këtë peshë nga pjesëmarrja e të gjithë brezave dhe dashamirësve, duke u përshëndetur e çmallur me njëri-tjetrin në sofrën ku flitet gjuha e nënës, respektohen prindërit e të afërmit dhe i jep jetë e gjallëri vendlindjes, Kallaratin tonë. Rrjedhën e kohës nuk mund ta kthejmë prapa, por dialektika e jetës e tillë është, që brezat bashkëjetojnë, ndahen, largohen në vende të tjera duke i dorëzuar stafetën njëri tjetrit, duke ruajtur zakonet, traditat, gjuhën, ndjenjën e dashurisë për prindërit, gjyshërit, për trojet e të parëve dhe vatrat në zjarrin e të cilave i kalitën këto cilësi të traditës, vlerat më të mira të bashkëjetesës, të dashurisë për punën, arsim, kulturë dhe për një jetë më të mirë.

Në vijim, Hasani vlerësoi rolin e emigrantëve, të cilët ruajnë traditat dhe dashurinë për vendlindjen si gjënë më të shtrënjtë, duke falënderuar të gjithë ata që kanë filluar restaurimin e shtëpive të tyre apo edhe ndërtimin e të reja, gjë që ua mundëson edhe rruga e re për të zhvilluar turizmin.

Rruga e Lumit të Vlorës, – u shpreh Hasani – është një ogur i mirë, por jo gjithçka, pasi, veç investimeve private, kërkohet nga pushteti vendor mbështetje më e madhe për sistemimin, kanalizimet, shërbimet shëndetësore, internetin etj.

Në fjalën e tij, Hasani vuri në dukje edhe disa nga arritjet e Shoqatës në 20 vjet të jetës së saj, si zhvillimin e një sërë veprimtarish me karakter atdhetar e kulturor, festimi i 20-vjetorit të klubi i Andonit në Vlorë, festimin e 80-vjetorit të lindjes së njërit prej personaliteteve më të spikatur të gjuhës shqipe, profesorit Rami Memushaj, kujtimin e 5 Majit, Ditës së Dëshmorëve, vendosjen e pllakës përkujtimore të qëndresës së Kallararit ndaj andartëve grekë më 1914, realizimin i emisionit televiziv për Bilbilin e Labërisë, Hyso Xhaferaj etj.

Në vijim të fjalës së tij, sekretari i Shoqatës falënderoi gjithë ata biznesmenë kallaratas që bënë të mundur realizimin e këtij takimi brezash, si edhe grupin organizues dhe kryetarin e fshatit z. Lefter Qejvanaj dhe dy bizneset private për mikpritjen.



Në fund të fjalës përshëndetëse, Hasani theksoi: "Duajeni dhe respektoni vendlindjen tuaj! Udhëhiquni nga motoja "Ec ngado, po Kallaratin mos e harro".

Së fundi, qershia mbi tortë është prania e të ftuarve specialë Maja, Ermira dhe Gjergji, që me magjinë e zërit të tyre do ta rritnin edhe më tepër adrenalinën e festës. Gëzuar!

Moderatorja: Mbrëmjen e sotme e kemi titulluar "Nata kallaratase", e ndërthurur fare

bukur me koncertin "Festojmë së bashku", me këngë e muzikë popullore, por edhe me këngë labe të traditës. Nata do të jetë e gjitha për ju. Sonte kemi rastin të këndojmë e hedhim valle si asnjëherë tjetër në sheshin para lapidarit, tashmë falë investimeve të qeverisë edhe të asfaltuar.

Siç e keni parë edhe nga programi i hedhur prej ditësh në fejsbukun e Shoqatës, sonte midis nesh, me dëshirën e madhe për

të kënduar para bashkëfshatarëve të tij, kemi këngëtarin e muzikës popullore vlonjate dhe me motive të Jugut, zotin Gjergj Leskaj, i cili me zërin e tij të ëmbël e melodioz do t'i japë një atmosferë tjetër këtij takimi.

Por kemi edhe ëmbëlsirën, të cilën e presim të na vijë nga çasti në çast. Kë do thoni Ju? E kush mund të jetë tjetër përveç MAJËS!?

Këngët e Gjergjit, tashmë të njohura e të përmbledhura në albumin e tij "Jam bir nga Labëria", por edhe këngë të tjera do të keni mundësi t'i ndiqni të kënduara prej tij drejtpërdrejt.

Këngët e Gjergjit do të shoqërohen në organo nga z. Donald Selimaj dhe në klarinetë nga zoti Artan Bendaj. Një duartrokitje për çunat e mrekullueshëm të orkestrës.

Përveç Gjergjit me këngë popullore, sonte do të këndohet patjetër labçe, vendçe, ashtu si i themi ne, sipas traditës, në tavolinat ku jeni ulur, shoqëruar me gotën e rakisë apo shishen e birrës, por edhe këtu para mikrofonit.

Çdo gjë do të jetë e lirë. Nata është e jona, le ta shijojmë atë.

Shikoj që Gjergjin nuk e mban vendi, mezi po pret të këndoje. Atëherë, pa humbur kohë, mikrofonin, shoqëruar me një duartrokitje, ia jap Gjergjit, se ndoshta para se të fillojë së kënduari, dëshiron të thotë diçka. "Është kënaqësi, por edhe përgjegjësi të këndosh para bashkëfshatarëve të tu", – e nisi fjalën



Gjergji dhe në vijim buçiti kënga e vallja.
Moderatorja: Kallarati, një nga fshatrat më të bukur e piktoreskë në Lumin e Vlorës,



ndryshëm, në festivale e takime të grupeve folklorike të zonës dhe më gjerë. Përveçse si grup, kënga labe, ashtu si në shumë zona të



Labërisë edhe në Kallarati është kënduar edhe njëzërëshe (monofoni) nga një njeri në raste gëzimi, të lindjes së një fëmije, por edhe në momente kritike të jetës, të dëshpërimit apo të vuajtjes. Kënga shpesh u jepte atyre kurajë dhe shpresë për të ardhmen.

Do të dëshironim që një këngë të tillë ta këndonte Zeqo Hoxhaj, ai që në festivalin folklorik të Gjirokastrës të vitit 1983 me këngën “Ç’u këput një këmbë mali” u bë i njohur për mbarë opinionin këngëdashës dhe u nderua me çmim. Ashtu siç mund të ishte mes nesh në këtë mbrëmje edhe Evgjëni Jonuzaj, ose Gjena siç e thërrisni ju, me këngën e saj “Djepi ynë burim floriri”, fituese edhe kjo në festivalin folklorik të Gjirokastrës të vitit 1983. Një duartrokje edhe për Gjenën, e cila me siguri na ndjek nga Londra.

Moderatorja: Por sonte këtij fshati i mungon fizikisht, por jo zëri e kënga e tij, i mungon “Bilbili i Labërisë”, “ai që me zërin e tij të veçantë, theu qelqet e qiellit”, siç do të thoshte poeti i madh i Labërisë Lefter Çipa. I mungon, pra, kësaj mbrëmjeje Hyso Xhaferaj.

Pata fatin e mirë, por edhe të keq që këtë figurë ta njoh me imtësi gjatë emisionit



“Autokton”, të njoh e të nxjerr në pah vlerat e larta njerëzore dhe talentin e tij të padiskutuëshëm të një zëri të veçantë e të rrallë. Me stafin që unë sonte kam këtu, me Arditin dhe Ertin, pikërisht këtu në qendër të fshatit, te shtëpia e tij në Trahile, në “Fshatin e Djegur”, aty ku stërgjyshi i tij Hyso Balil Xhaferaj luftoi me pushkë dhe dha jetën për mbrojtjen nga andartët grekë më 1914, ndërsa Hysua i ditëve tona me zërin e tij pushkë ngriti më lart vlerat e Kallaratis. Pikërisht me këto episode ndërtaam emisionin televiziv në kujtim të tij, një nga emisionet më të ndjekura për publikun dhe shikuesit e News 24, për të cilin kemi marrë mesazhe pa fund’.

Artistët nuk kanë vdekje, sepse lënë pas një trashëgimi të vyer për brezat e ardhshëm.

Edhe për Hyso Xhaferajn nuk ka vdekje, se natyra e bëri bilbil, ndaj zëri i tij do të jetojë me ne, aq sa do të jetojë edhe vetë polifonia labe. Në kujtim të Hysos, le të dëgjojmë disa këngë të kënduara prej tij.

Moderatorja: Në këtë mbrëmje kemi edhe një këngëtare tjetër të muzikës popullore të Jugut dhe të serenatave korçare, Emrira Kola (Strati), bijë nga Korça e nuse në Kallarati. Në fjalën e saj Ermira shprehu kënaqësinë që ishte e pranishme së bashku me vëllazërinë Strataj në këtë takim brezash dhe aq më tepër të këndonte së bashku me këngëtares e njohur vlonjate dhe miken e saj të ngushtë, Maja dhe me Gjergjin. Këngët e saj e sidomos serenatat korçare u mirëpritën dhe u duartrokitën pa masë.

Takimi vijoi me këngë e valle, kërcime e



intervista e mesazhe para mikrofonit, duke falënderuar organizatorët për zhvillimin e takimit të brezave në mënyrë të përkryer.

Mbyllja e takimit

Moderatorja: Të dashur pjesëmarrës! Besoj se kënduam e kërcyem dhe kaluam një mbrëmje të veçantë dhe tani erdhi çasti që këtë veprimtari ta mbyllim për sonte. Faleminderit pjesëmarrësve! Ishit të paparë. Faleminderit banorëve të Kallaratis për mikpritjen! Faleminderit Shoqatës! Faleminderit këngëtarëve dhe orkestrës fantastike! Faleminderit bashkëpunëtorëve të mi, Arditit dhe Ertit. Mirë u takofshim në aktivitete të tjera.

FALËNDERIM I KRYESISË SË SHOQATËS PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN ME SUKSES TË TAKIMIT TË BREZAVE

Ashtu siç ishte paralajmëruar prej muajsh më parë, në datën 12 gusht 2023 në Kallarati, në një atmosferë tepër festive u zhvillua me sukses “Takimi i Brezave”. Kryesia e Shoqatës Kallarati falënderon të gjithë pjesëmarrësit, banorët vendas, të ardhurit nga çdo qytet i Shqipërisë dhe emigrantë, në mënyrë të veçantë të rinjtë e të rejtat, që gjetën mundësinë të merrnin pjesë, madje edhe jashtë parashikimeve tona, rreth 600 veta.



Kjo tregon dashurinë që kanë kallaratasit për vendlindjen dhe origjinën e të parëve të tyre. Në mënyrë të veçantë falënderojmë këngëtarët Maja Alickaj, Ermira Kola, Gjergj Leskaj, të cilët e ndezën flakë sheshin në qendër të fshatit. Falënderojmë sponsorizuesit e takimit: Ylli Breshanaj, Mirjan Ribin, Artur Strataj, Arjanit e Hektor Rjepaj, Bujar Memushaj, Afërdita Breshanaj (Hysaj), Bako Xhaferaj, Asllan Shakaj, Afërdita Breshanaj, Shkëlqim e Andon Leskaj, Robert Mehmetaj, Evgjëni Jonuzaj, Martin Boçaj etj, pa kontributin e të cilëve ky takim nuk mund të zhvillohej.

Një falënderim tepër të veçantë për grupin e medias të “News 24”, gazetaren e njohur Anila Ahmataj, e cila me aftësinë e përvojën si gazetare i bëri një moderim të shkëlqyer takimit; regjisorin Ardit Zotaj së bashku me montazhierin Erti Ahmataj, të cilët nëpërmjet kamerës, aparatit fotografik dhe dronit, nuk lanë aspekt pa filmuar në një mënyrë tepër profesionale, të cilët së shpejti për cilindo nga ne do të bëjnë një video tepër profesionale.

Falënderojmë dy bizneset private: Ergys Hoxhaj me gjithë punonjësit e tij, Vangjel Ribin e Elidian Gjombatin, të cilët realizuan një shërbim të përsosur me ushqime tradicionale bio e pije të freskëta.

Po kështu, falënderojmë edhe gjithë banorët e tjerë dhe kryetarin e fshatit Lefter Qejvani për masat e marra për pritjen e të gjithë të ardhurve.

Përvoja e fituar le të na shërbejë për takimin e vitit tjetër.

GAZETARJA DHE MODERATORJA E TAKIMIT TË BREZAVE, ANILA AHMATAJ FALËNDERON



Të duash dhe të respektosh historinë dhe kulturën e vendlindjes tënde, është jo vetëm detyrë, por edhe obligim!

Falënderoj në mënyrë të veçantë shoqatën “Kallarati” dhe organizatorët e takimit të brezave në fshatin e Kallaratis, që më besuan mua të moderoja mbarëvajtjen e asaj nate të mrekullueshme, me njerëz të mrekullueshëm dhe me një hare të jashtëzakonshme...

Nuk ishte thjesht një festë, por një mesazh për brezat...

Të gjithë këtë veprimtari madhështore do të keni mundësi ta ndiqni të plotë shumë shpejt...

sonte ka privilegjin e kënaqësinë të ketë të pranishme një këngëtare të madhe të muzikës popullore të Jugut, e pikërisht MAJËN. Një duartrokje të fortë për të dhe për ata djem



kallaratas që e bënë të mundur ardhjen e saj dhe le të çohemi në këmbë në respekt të vlerave që ajo mbart.

Dhe tani mikrofonit e orkestra për ju, Maja. Ndize këtë vend! Të këndoftë shpirti e zemra!

Maja në fjalën e saj falënderoi gjithë kallaratasit për pjesëmarrjen, falënderoi praninë e shoqes, këngëtares tjetër Ermira Kola, atë që bëri të mundur ardhjen në këtë takim, Ylli Breshanin, si dhe Bujar Muçon, i cili kishte qenë sponsori i parë në vitin 2006 për të marrë pjesë në një koncert në Greçi.

Moderatorja: Ju ftoj t’i shoqërojmë këngët e Majës me valle, siç i ka lezet këngës.

Moderatorja: Të pranishëm në këtë mbrëmje kemi edhe mjaft emigrantë kallaratas, të cilët pas viteve ‘90 ikën jashtë vendit për një jetë më të mirë dhe mundësi më shumë për fëmijët e tyre. Megjithëse larg, si në Greçi, Itali, Francë, Spanjë, Belgjikë, Angli e deri në Kanada e Amerikë, mendjen dhe shpirtin e kanë në vendlindje, në Kallarati. Faleminderit që jeni të pranishëm.

Të gjithë të ardhurit në këtë takim, por edhe ata që nuk kanë mundur, por që me siguri na ndjekin, i përhëndesim me këngën “Mëmëdhe”, kënduar nga Maja.

Moderatorja: Ashtu si në gjithë Labërinë, kënga labe në Kallarati ka qenë dhe është pjesë e jetës. Ajo ka qenë dhe është e pranishme në çdo vatrë të tij, në çdo rast gëzimi familjar, dasmash, në raste festash e përvjetorësh të



KRONIKË E NJË FSHATI QË PO RINGJALLET



NGA LEFTER HYSAJ

Kallarati, ky fshat i Labërisë dhe i Kurveleshit të Poshtëm, i vendosur në anën e majtë të rrjedhjes së Shushicës, pjesë e njësisë administrative Horë-Vranisht të Bashkisë së Himarës, përshkohet në tërë gjatësinë e shtrirjes së tij nga rruga e re Vlorë-Qeparo, e cila u ka dhënë frymëmarrje të gjitha fshatrave të Luginës së Shushicës. Rruga e re ka bërë që fshati të gjallërohet, të mendohet për ringritje ekonomike, të mendohet për bujtina e për turizëm, të bëhet plazh në Borsh e Qeparo e gjumin ta bësh për shtatë palë qejfe në Kallarati.

Në historinë e tij, Kallarati përmendet që në vitin 1432 në regjistrat e kadastrës osmane si një fshat me sipërfaqe dhe popullsi të konsiderueshme, më vonë në vitin 1507 del si fshat rebel, më 1581 përmendet në letrën dërguar Papatit në Romë dhe më 1759 në letrën dërguar careshës së Rusisë. Gjatë historisë së tij Kallarati ka rënë dhe është ringritur disa herë. Thonë që origjinën e ka nga pllaja e Kurveleshit të Sipërm. Banorët u vendosën në vendin e quajtur Kunjovë, një vend i bukur me këndvështrim nga perëndimi. Rreth viteve 1700 për shkak të kolerës, por dhe të konflikteve për kullota me fshatrat Kuç e Bolenë, fshati u shpërngul dhe u vendos në Pllajën e Pilingrisë, në shpatin lindor të malit të Bogonicës. U ndërtua një vendbanim i ri, ndoshta më i bukur në gjithë Labërinë, me planimetri, i vendosur sipas mëhallëve, me rrugë që lidhnin të gjitha mëhallët me xhaminë në qendër të fshatit, me ndërtesa guri dykatëshe, mure të cilat edhe sot pas 109 vjetësh janë në këmbë si për të dëshmuar qëndrueshmërinë ndaj armikut dhe së ligës. Por në korrik 1914, në zbatim të planit shovinist të Vorioepirit, andartët grekë të mbështetur nga antishqiptari Spiro Milo, pas një qëndrese heroike të banorëve, e dogjën plotësisht fshatin e bukur në pllajën e Pilingrisë, duke lënë mbrapa gjurmët e një shovinizmi që e ndiejmë edhe sot.

Për herë të dytë Kallarati ra, por nuk vonoi dhe pas dy-tre vjetëve fshati u ndërtua në të dy anët e Shushicës, me shtëpitë afër tokave bujqësore. U dogj përsëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, por në vitet 1946- 1948 shtëpitë u



rindërtuan me vullnetarizëm. Në vitet 1970-1980, në zbatim të planit të krijimit të qendrave

Në vitet '90, me ndryshimin e sistemit, filloi një rënie tjetër, braktisja e fshatit nga



te fshatrave me projekte të urbanizuara, Kallarati pothuaj u zhvendos i tëri. U ndërtuan rreth 50 shtëpi të reja, duke u përqendruar në tre lagje: Morrez, Qafë e Ubavit dhe Basha.

pjesa më e madhe e popullsisë drejt qyteteve apo shteteve të tjera për një jetë më të mirë. Në vitin 1989 Kallarati kishte 136 familje dhe afërsisht 640 banorë, nga të cilët 40% ishin fëmijë 0-14 vjeç. Kishte çerdhe, kopsht, shkollë, qendër shëndetësore, maternitet, mjek, infermier, mami, vatër kulture, grupin e njohur folklorik. Edhe pse në kushtet e varfërisë ekonomike, jeta sociale e kulturore ishte plot gjallëri, si për të dëshmuar vitalitetin e kallaratave.

Sot në Kallarati banojnë 30 familje me një, dy apo tre anëtarë, fëmijët numërohen me gishtat e dorës. Por rruga e re ka bërë që të lindë shpresa për një ringjallje tjetër edhe më të bukur e më të fortë se herët e tjera. Dhe kjo shpresë u shpreh më së miri në festën "Takimi i brezave", organizuar nga Shoqata A/K Kallarati dhe kryesia e Fshatit më 12 gusht 2023. Atë mbrëmje qendra e fshatit, e zbuluar dhe e ndriçuar më së miri, u mbush nga mbi 600 pjesëmarrës, të ardhur nga gjithë anët, nga Kanadaja e largët, nga Franca e Gjermania, nga Italia e Greqia, nga Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, Korça, miq nga Belgjika e Kosova. Erdhën jo vetëm emigrantët, të moshuar e të rinj, erdhën nipër e mbesa që kanë lindur jashtë vendit apo fshatit, erdhën nuse e dhëndurë të Kallaratit. Mes fëmijëve që lodronin në shesh, ishin Glauku trevjeçar nga

Italia, Lukasi nga Tirana, Irisa nga Vlora e plot të tjerë që atë mbrëmje shijuan atmosferën e bukur të kësaj nate vere. Festa kaloi shumë këndshëm me këngët e këngëtarëve Maja Aličkaj, Ermira (Kola) Strati, nuse në Kallarati, e Gjergj Leskaj. Pjesëmarrja e grupi të xhirimit të emisionit "Autokton" të gazetares Anila Ahmataj ishte një plus i kësaj ngjarjeje. Këngët dhe vallet vazhduan gjer në orët e para të mëngjesit të datës 13 gusht.

Kjo feste e hareshme është lajmëtare gëzimsjellës se Kallarati po ringjallet përsëri. Shenjat e kësaj ringritjeje janë të shumta. Janë shtëpitë e reja të bukura dhe komode të ndërtuara së fundi nga Arjanit e Hektor Rjepaj, Miri Ribaj, Myzafer Qejvani, Agron



Tozaj, Rimi Memushaj e të tjerë. Janë ngastrat me drurë frutorë, si arra, lajthi, ullinj etj., të mbjella nga Luan Jonuzi, Gledion Hysaj, Hasan Mehmetaj, Lavdosh Jonuzi, Kastriot Qejvani etj. Janë përpjekjet për të ngritur biznese shërbimesh. Në Kallarati fryn era e turizmit. Bijtë e bijat kallaratase janë plotë dëshirë e ide për të investuar në fshat, për të kontribuar, jo vetëm për veten e tyre, por dhe për komunitetin, ashtu siç bënë për festën Ylli Breshani, Arjanit e Hektor Rjepaj, Bujar Memushaj, Andon e Shkelqim Leskaj e plot të tjerë.

Por ringjallja e fshatit dhe dëshira e kallaratave për të ngritur jetën dhe ekonominë aty ku është trualli i të parëve, aty ku kanë kujtimet e fëmijërisë, aty ku kanë rrënjët, që i mbajnë të lidhur fort me këtë vend të bukur mes lumit Shushica e malit hijerëndë të Bogonicës, kërkon edhe vëmendjen dhe mbështetjen e pushtetit vendor për të zgjidhur disa probleme, të cilat ndikojnë jo pak në të sotmen dhe të ardhmen siç janë: menaxhimi topografik dhe kadastral i trojeve dhe tokave e kullotave të Kallaratit, sepse pengon planet zhvillimore, siç janë ndërtimet e reja, mbrojtja e tokave bujqësore nga gërryerja, sidomos pas ndërhyrjeve në shtratin e lumit për të marrë inerte (gjer tani janë mbi dy hektarë tokë e gërryer), ndriçimi rrugor në qendrat e lagjeve. Kallaratasit janë gati ta ringrenë fshatin e tyre, ashtu siç kanë bërë disa herë gjatë historisë, veçse krahas dëshirës dhe vullnetit të mirë të banorëve duhet edhe mbështetja e shtetit dhe e pushtetit vendor.

Mirupafshim në festën e ardhshme në fshatin tonë të bukur!

Kallarati, më 13.08.2023





NGA IDAJET JAHAJ

18 TETOR 1942 – 18 TETOR 2023, 81-VJETORI I RËNIES SË HEROIT TË POPULLIT MUMIN SELAMI DHE I 4 HERONJVE TË TOPANASË

“MBI KOCKAT E MARTIRËVE NGRIHET ATDHEU” *Përsiatje mbi ditarin e Heroit të Popullit Mumin Selami*

Ai jetoi vetëm 19 vjet. Edhe kaq sa rroi, jeta e tij qe e ngjeshur me etje diturie e veprimtari në shërbim të atdheut. Ai karakterizohej nga aspirata e thellë e dijes, veçori kjo edhe e shumë intelektualëve të tjerë që kishte nxjerrë fshati i tij. Kjo aspiratë përshkonte tërë qenien e tij. Shkroi disa hartime e skica meditative, që në vitet 1939–41, kur ishte gjimnazist në Tiranë.

Pak skica i janë gjetur, por një thesar i vërtetë është ditari i tij. Megjithëse i shkurtër, rreth 18 faqe, ditari është ruajtur me shkrimin e tij, në një fletore pak të zverdhur nga koha e gjatë.

Ky thesar shënimesh është lagur me lotët e nënës së tij, Duzes së famshme, apo të afërmve të tij që e kanë ruajtur me fanatizëm atë, nëpër dekada si një relike të çmuar shpirtërore, të një kohe dhe epoke të trishtshme. Sepse atëherë vendi ishte i pushtuar e i shtypur nga të huajt dhe bota përvëlohej në flakët e Luftës së Dytë Botërore.


Djaloshi Mumin ishte vetëm 18 vjeç kur e internuan nga Tirana në fshatin e tij, në Kallarati. Aty ai kaloi pak kohë, pranë nënës së tij të dashur e bashkëfshatarëve të respektuar. Aty ai pa lotët e mjerimit të popullit, pa qiellin plot me aeroplanë që hidhnin fletushka fashiste, pa natyrën e maleve të Lumit të Vlorës plot madhësi për krenarinë e lirisë, male që kultivonin aq e aq virtyte të rralla ndër banorët e tyre. Aty ai ndjeu rrahjet e një zemre të madhe që rënkonte gjëmimshëm nga mjerimi e shtypja; pa mundimin gjigant të punëtorëve të xhadeve, që zvarriteshin si thnegla të mjuara kockë e lëkurë...

Të gjitha këto ai i shkroi ditë pas dite në një ditari, me laps kopjativ (që nuk i humbet boja), në një fletore fletëgjatë e vijagjerë. Fletorja u ruajt, por për çudi e paralelizëm, – ashtu si jeta e tij, – e ndërprerë në mes. Thotë në fund të 18 faqeve “vijon”, por është ndërprerë nga vetë ai, apo ka humbur pjesa tjetër? Megjithatë, dritën e thesarit nuk e pengon as gjysma. Edhe sikur të ishte vetëm një fjali apo një pasazh i tij, do të ndriçonte sërish... Sepse thesari ndriçon edhe në një grimcë.

Mendime të habitshme, për kohën dhe moshën e heroit. Pra, ai ishte dy herë hero: për veprimtarinë, gjakun dhe për shkrimet e mendimet e tij të dritta.

Ja një kryemaksimë e tij: “Mbi kockat e martirëve ngrihet atdheu.” Po sa e sa të tjera ka rreshtuar e dritësuar ai? Këtu poshtë po renditim disa esenca të tilla të atij djaloshi-hero.

Ai shkruan për botën, luftën, varfërinë, bashkëfshatarët, malet e vendlindjes, vashëzën që u varros në lëndinë, nënën, kohën, qiellin me vija avionësh, skeletet e punëtorëve... për burrin që loton se s’ka bukë për të ngrënë, për fëmijën e copëtuar nga bomba, për lulet, barin, lëndinën, ëndrrat, dashurinë... për çfarë nuk ka shkruar hero i penës edhe në ato pak faqe! Fare pak mundësi i la koha e jeta të shkruante, por edhe ato ndriçojnë. Ndriçojnë mendimet e një të pjekuri në moshë, ashtu si profili i gjithë të rinjve “të thinjur” të viteve 30-40 të shekullit të kaluar. Edhe Mumin i Vlorës, i Kallaratit, me ato pak shkrime të tij ndriçoi e rreshtohet për nga tematika e forca shprehëse poetike-



filozofike, krahas autorëve të tjerë të rinj e të shquar të kohës, si Qemal Stafa, Veli Stafa, Nonda Bulka, bashkëkrahinori i tij Shefqet Musarai etj., etj.

Sashumë do ta kishte pasuruar publicistikën apo krijimtarinë e tij të mëvonshme djaloshi Mumin, nëse plumbi fashist nuk do t’i kishte prerë jetën! Humbje të tilla janë fatkeqësi të mëdha. Jo më kot bilibili tjetër i madh poetik i krahinës së Lumit të Vlorës, oratori Memo Meto nga Kuçi, do të shkruante elegjinë e famshme për shokun e tij të penës, Muminin

e Kallaratit:

*Bogonica me Çipinë ç’kanë që qajnë me lot?
Qajnë me lot për Muminë, që s’e shohin këtu sot.
Të bën grupe me rininë, siç bënte para një mot.
Të mbledhte djalërinë, se kishte për t’i thënë plot,
I lindur për Shqipërinë, shënimet ia gjeta sot.
S’ka fat e shkreta krahinë, shokët të qajnë me lot.*

Poeti qan poetin, hero i qan heroin. Kjo elegji hyn ndër më të ndjeshmet e tilla në vjershërimin poetik të njerëzve të shquar të vendit. Bën dritë dhe është e denjë për antologjitë e kujtesës së kombit...

Maja e zezë e plumbit i preu jetën Mumin... Por ai la shembullin e madh të heroit pas: të heroit të gjakut, por edhe të mendimeve...
*Ja disa maksima të tij:
– Nuk di në është paqe apo jo.
– Shumë e fortë është zemra e njeriut.
– ...Se sa bukur qytetërimi botëror i sotëm ka mundësi të copëtojë sa e sa trupa njerëzish.
– Bota është e më të fortit dhe e më të madhit.
– Drejtësia ndër popuj vdiq, padrejtësia dhe gënjeshtria mbizotërojnë...
– Lufta është rrënuesja e njerëzimit.*

4 NËNTOR 1944 – 4 NËNTOR 2023, 79-VJETORI I KONGRESIT TË PARË TË BGASH-it. NËNË DUZE BAJRAMAJ, DELEGATE E KONGRESIT TË PARË TË BGASH-it, MBAJTUR MË 4 NËNTOR 1944 NË BERAT.


Midis 311 delegatëve të Kongresit të Parë të Bashkimit të Grave Antifashiste Shqiptare (BGASH), mbajtur në Berat më 4 nëntor 1944, ishte edhe Duzë Bajramaj nga Kallarati, nëna e Heroit të Popullit Mumin Selami.

Kongresi i Parë i BGASH-it, që i bëri një analizë punës së kryer për përmbushjen e objektivave të LANÇ-it, u ndal në rolin dhe kontributin e gruas shqiptare, si një forcë e madhe aktive dhe përcaktoi detyrat që i dilnin BGASH-it pas çlirimit të vendit, për rindërtimin e Atdheut të shkatërruar nga lufta, për luftën kundër analfabetizmit e në përgjithësi për rritjen e rolit të gruas shqiptare në të gjitha fushat e jetës.

Kongresi u dha impulse të reja delegateve, të cilat do të përcilleshin në të gjithë masën e grave shqiptare për të përmbushur detyrat e mëdha e të vështira që i pritnin. Mbas mbarimit të punimeve të Kongresit, delegatet u ndanë me njëra-tjetrën me urimin “Mirupafshim në Shqipërinë e lirë!”.

Vendimet e Kongresit qenë historike, ato i dhanë një impuls Luftës ANÇ; qytete e krahina vazhduan të çlirohen njëra pas tjetrës e nuk vonoi shumë dhe më 29 nëntor 1944 Shqipëria u çlirua.

Po cila ishte Nënë Duzja? Nënë Duzja lindi në Bolonë më 1890, në familjen e Mingajve, dhe u martua në Kallarati me Selam Bajramin. Karakteri dhe shpirti




luftarak i saj u sprovuan në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ajo jo vetëm nuk u thye nga humbja e djalit, Mumin Selamit, por u bë një veprimtare e shquar e LANÇ-it në Lumin e Vlorës, duke u kthyer në një simbol të gruas antifashiste e atdhetare. Krijoi në fshat organizatën e gruas antifashiste, u zgjodh anëtare e Këshillit Krahinor të Kurveleshit dhe të Qarkut të Gjirokastrës. Pjesëmarrëse në kongresin e parë të Gruas Antifashiste në Berat, deputete në Kuvendin Popullor në dy legjislatura. U nda nga jeta më 31 maj 1961.

28 NËNTORI, “DITA E FLAMURIT”

Kallaratasit, ashtu si mbarë kombi shqiptar, festuan me madhësi e krenari 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit. Kjo ditë është një ngjarje e shënuar, sepse për herë të parë Shqipëria shpalli Pavarësinë e saj dhe në këtë ditë në Vlorë, patrioti Ismail Qemali, së bashku me patriotët e tjerë, ngriti flamurin kombëtar.

Këtë ngjarje të shënuar të historisë së kombit tonë shqiptarët e festojnë anembanë botës ku ndodhen. Por një pjesë e kallaratasve me banim në Amerikë, ka disa vjet që “DITËN E FLAMURIT” e festojnë përkrah familjeve të ushtarakëve shqiptarë të NATO-s, në Norfolk të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. E tillë është familja e Myzafer Qejvanit dhe e djalit të tij Selos.



**KËNGË KUSHTUAR
NGRITJES SË
FLAMURIT NË
SHKOLLËN E
KALLARATIT MË 28
NËNTOR 1919, nga
Hasan Kallarati**

*Mu te shkolla me përralle,
bëhej fest' e hidhej valle,
viti ish nëntëmbëdhjetë,
muaji i njëmbëdhjetë,
dita e njëzetetë.
Ishte Dita e Flamurit,
Dita e Flamurit tonë,
që u ngre më dymbëdhjetë,
nga Ismaili në Vlorë.
Populli ishte mbledhë,
ishte mbledhë në shkollë,
nxënësit po këndojnë,
Hymnin e Flamurit tonë,
me flamuj të kuq në dorë.
Një fjalim mbajti Meçani,
për mbi historinë tonë,
po një spiun që ish shitë,
me të shpejtë lajmëroi.
Nuk shkuan shumë ditë,
që Kallaranë e rrethoi,
karabinier e milicë,
dhe gjashtë vet'arrestoi:
Meçan e Selam Barjamnë,
Shamon* e Alem Qejvanë,
Dudën e Remzi Janjnë,
që qenë si kryetarë.
Lidhur i shpunë Himarë,
vdekjenë me sy e panë,
nga torturat që u dhanë,
pastaj në këmbë i nisë,
kaptuanë Llogaranë;
dhe në Vlorë i degdisnë.
Katër muaj diell s'panë,
të mbyllur në qeli,
në Manazgja në hapsanë
më njëzetë nëntë marsi,
në gjyq ushtarak i dhanë.
Prokurori në seancë,
i cilëson tradhëtarë,
dhe si të tillë fajtorë,
kërkoi vdekjen në litarë,
po me para e miq shumë
pafajësinë u dhanë.*

**Shamo Meçaj,
babai i autorit të kësaj kënge.*



29 NËNTORI, “DITA E ÇLIRIMIT” TË ATDHEUT LAVDI DËSHMORËVE TË KALLARATIT DHE GJITHË SHQIPËRISË!

Edhe këtë ditë të shënuar të historisë së popullit tonë, 29 Nëntorin, Ditën e Çlirimit, kallaratasit e festojnë me krenari kudo që ndodhen. Në këtë ditë shënuar kallaratasit vendosin kurora e buqeta me lule pranë lapidarit në qendër të fshatit kushtuar 27 dëshmorëve të Kallaratis që dhanë jetën për mbrojtjen dhe çlirimin e vendit, por edhe për demokracinë.



BASHKIM SAMI DAVACI, ZGJIDHET KRYETARI I RI I FSHATIT

Në kuadrin e zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave të bashkisë Himarë, mbështetur në ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, gjatë muajit tetor 2023 u zhvilluan zgjedhjet në fshatra.

Në zgjedhjet që u bënë në Kallarat më 7 tetor 2023, me votim të hapur të zgjedhësve të tri lagjeve – Morrez, Basha dhe Qafë e Ubavit – në praninë edhe të komisionit të votimit të bashkisë dhe përfaqësuesit nga komuniteti vendas, kryetar i Fshatit u zgjodh z. BASHKIM SAMI DAVACI, me banim në Kallarat. Deri tani këtë detyrë e mbante z. Lefter Qejvanaj.

Kryesia e shoqatës “Kallاراتi” falënderon z. Lefter për punën e bërë në detyrën e kryetarit të fshatit dhe në të njëjtën kohë i uron z. Bashkim suksese në detyrën e re, duke qenë gjithmonë pranë halleve e problemeve të komunitetit në pajtim me detyrimet e të drejtat që i jep ligji.

Kemi besim se me një bashkëpunim të frytshëm të kryesisë së fshatit, drejtuar nga z. Bashkim Davaci, dhe kryesisë së shoqatës “Kallاراتi”, drejtuar nga z. Kastriot Karabolli, ashtu si deri tani, banorët që banojnë në Kallarat

dhe të gjithë të larguarit brenda e jashtë vendit, do të punojnë së bashku pa dallime partiake për të njohur, propaganduar e ngritur më lart vlerat patriotike e kulturore të Kallaratit, duke organizuar së bashku veprimtari në kujtim të ngjarjeve e të datave të rëndësishme të fshatit në periudha të ndryshme të historisë; për të kujtuar e vlerësuar figurat më kryesore që kanë dhënë kontribut të veçantë për Kallaratit e kanë lënë gjurmë në punën e tyre në sektorë të ndryshëm të jetës brenda e jashtë tij, duke lartësuar emrin e vendlindjes, Kallaratit; për kontributin në luftën për çlirim kombëtar, për liri e demokraci; për kontributin në fushën e arsimit, kulturës, sportit, bujqësisë, blegtorisë, mbrojtjes, sigurisë, në sektorin privat, etj., pavarësisht ku banojnë e jetojnë; në promovimin e figurave të reja në kohën e sotme, sidomos të rinjtë e të rejtat, duke organizuar çdo vit veprimtarinë më të mirëpritur, atë të “Takimit të Brezave”, dhe veprimtari të tjera kulturore e patriotike. Të gjithë dhe gjithçka për Kallaratit nën moton: “Ec ngado, po Kallاراتi mos e harro”! Suksese!

Kryesia e shoqatës “Kallاراتi”



NGA BESNIK GJONBRATAJ

AVENTURA E GENTIAN QEJVANIT: ME BIÇIKLETË KINË-SHQIPËRI, DUKE E PËRFUNDUAR ATË NË KALLARAT

(Premtim i dhënë në Takimin e Brezave në gusht të vitit 2023)

Gentian Qejvani, i ndodhur prej disa ditësh në Kallarat (pasi prej 10 vjetësh jeton në Kinë), ardhur me mjetin e tij të preferuar, biçikletën, mori pjesë për herë të parë këtë vit më 12 gusht 2023 në takimin e brezave në vendlindjen e babait të tij Memo Qejvanaj. Personalisht nuk isha në dijeni se Genti ndodhej pikërisht në këtë takim. Po ta shihja, edhe pse nuk isha takuar me të asnjëherë, do ta njihja, pasi e kam ndjekur nëpërmjet videove të tij në Youtube, por duke qenë pjesëmarrje e madhe, si asnjëherë tjetër, jo me të gjithë arrita të përshëndetesha e të takohesha. Duke qenë se isha duke ndjekur prezantimin e moderatores, në kohën që poetesha Lela Qejvani në fjalën e saj përshëndetëse përmendi faktin që në këtë takim brezash kanë ardhur shumë emigrantë nga jashtë e duke përmendur Kinën, mendja më shkoi te Gentiani. Sapo Lela përfundoi fjalën e saj, i them. Ku është Gentiani? Me të përkraku i afrohem tavolinës së madhe ku ishte vendosur fisi Qejvanaj dhe menjëherë dallova portretin e Gentianit, veshur sportiv. Ngaqë moderatorja ishte duke pritur këngëtarën Maja, që krijoi një pauzë, që ishte mundësia më e mirë për Gentin të bënte një prezantim e përshëndetje, pa u përshëndetur e pa u prezantuar fare me të, e marr Gentin për krahu dhe i afrohem Anilës e i them: “Genti është një djalë me origjinë nga Kallاراتi, sportist në Kinë dhe do t’u japë një mesazh pjesëmarrësve”. Dakord, – tha Anila, – mikrofonit është për të. Kështu ndodh edhe në spektakle më të mëdha, kur del diçka jashtë skenarit, por që është shumë herë më e bukur se ato të planifikuara.

Genti mori në dorë mikrofonin dhe në fjalën e tij, pasi u prezantua me një shqipe të kuptueshme, falënderoi organizatorët për këtë veprimtari shumë të bukur, i përshëndeti të gjithë dhe në fund dha fjalën se në takimin e brezave në muajin gusht 2024, datën caktojeni ju, do të vij në Kallارات me biçikletë nga Kina. Duartrokitje të mëdha nga pjesëmarrësit ushtuan në sheshin. Le të shpresojmë të Genti në bërjen realitet të kësaj aventure të re.

Genti, megjithëse është diplomuar për Shkenca Politike në Itali, ka punuar në Parlamentin Europian, ka kryer doktoraturë në Kinë për çështjet publike me një studim krahasues



midis Shqipërisë dhe Kinës, pasioni i tij mbetet “aventura” nëpërmjet çiklizmit, ecjeve të gjata në terrene të vështira, si dhe ndihma ndaj njerëzve në nevojë. Kudo synon të jetë i pari e të ngrejë flamurin kombëtar shqiptar.

Kam kohë që nëpërmjet disa videove e shoh Gentianin në Kinë si pjesëmarrës dhe fitues në shumë gara me biçikletë ku valëvit flamurin tonë kombëtar, në ngjitje malore sportive e plot veprimtari të tjera. Pasioni i tij është të ecë me biçikletë, të vrapojë në distanca të gjata, duke dhënë mesazhin e vëllazërimit midis njerëzve dhe popujve dhe ndihmën ndaj njerëzve në nevojë, sidomos fëmijëve, në mënyrë të veçantë gjatë pandemisë COVID-19.

Gentiani ka shkuar vullnetarisht në Mandagastar për të ndihmuar fëmijët e varfër, duke u munduar të përcjellë një mesazh paqeje në Afrikë dhe Kinë gjatë kohës së vështirë të koronavirusit.

Para disa vjetësh Gentiani së bashku me 5 kinezë ishte në Berat, Vlorë e Sarandë, pa anashkaluar edhe Kallaratit, vendlindjen e babait të tij Memo Qejvanit, njeriut të urtë e punëtor, për të promovuar turizmin dhe bukuritë natyrore të Shqipërisë.

Gentiani shquhet për aventurat e tij, por me një domethënie e mesazh të qartë: të miqësojë njerëzit e popujt, të promovojë vlerat dhe të ndihmojë njerëzit e varfër, veçanërisht fëmijët.



Aventura e re e Gentianit do të jetë maratona me biçikletë KINË – SHQIPËRI, të cilën e deklaroi në takim dhe kërkon mbështetjen e të gjithëve.

Duke besuar se shpreh edhe mendimin e gjithë kallaratasve, le ta falënderojmë Gentin për pasionin që ka, e ta mbështetim në punën e tij dhe në gjithçka që bën nëpërmjet sportit, duke e bërë të njohur Shqipërinë në Kinë e largët dhe në vende të tjera e duke valëvitur flamurin kombëtar kuqez, për të cilat na bën krenar edhe ne si fshat. Atje, në Kinë e largët, kur ngrihet flamuri ynë kombëtar, është një lojë sikur është ngritur flamuri i Shoqatës që identifikon Kallaratit.

Gentit i urojmë suksese dhe e mbështetim në aventurën e tij të re vitin e ardhshëm me biçikletë Kinë-Shqipëri e ta përfundojë atë në Kallارات më 17 gusht 2024.

Për diçka më shumë për jetën dhe veprimtarinë e Gentianit, lexoni një përmbledhje më poshtë, të cilën ma dërgoi me kënaqësi, pas kërkesës së bërë për ta pasqyruar në fejsbukun e shoqatës “Kallاراتi”.

Gentian Qejvani ka lindur në Vlorë më 31.08.1987 nga prindërit e tij Memo Qejvani nga Kallاراتi dhe Zamira Isufi. Memua, babai i Gentianit, rrjedh nga një familje e thjeshtë dhe bujare kallaratase. Ai u nda nga jeta në një moshë të re, duke lënë pas dy fëmijë në moshë të mitur: Fatjon dhe Gentian Qejvanin.

Në kohën e ndryshimit të sistemit, mamaja e Gentianit i mori dy fëmijët e mitur dhe emigroi në Itali. Me sakrificë dhe përkushtim, ajo i rriti edukoi dhe shkolloi dy djemtë e saj që u diplomuan në shkollat e larta italiane.

Gentiani u diplomua në Itali për Shkenca Politike, ka kryer masterin në Bruksel. Gjithashtu, ka punuar një vit në Parlamentin Europian. Mbase mbaroi masterin, ai shkoi në Kinë, ku vazhdoi të studionte, duke i kurorëzuar studimet doktorale me një studim krahasues për çështjet publike me midis Shqipërisë, me të cilin fitoi gradën e doktorit në filozofi (PhD).

Gentit nuk i mjaftoi karriera akademike, por vazhdoi të merret me veprimtari shoqërore dhe sportive që zhvillohen në Kinë, ku ka dalë fitues dhe ka marrë çmimin e parë në disa maratona kineze, si edhe duke lartësuar flamurin shqiptar në çiklizëm. Ai vazhdon të promovojë Shqipërinë dhe kulturën shqiptare në Kinë, duke u përpjekur të jetë një urë lidhëse midis dy vendeve, për më tepër vitin e ardhshëm ai planifikon të ngasë biçikletën nga Kina në Shqipëri në mënyrë që të promovojë lidhjen midis dy vendeve.

Për më shumë informacion, mund ta ndiqni në Youtube, ku Gentiani ka kanalën e tij të quajtur “G productions”.

<https://www.facebook.com/1470828602/posts/10224678931908627/?app=fbl>

Intervistoi: **BESNIK GJONBRATAJ**

KËNGËTARJA MAJA (MAYA) ALIÇKAJ NË TAKIMIN E BREZAVE NË KALLARAT

Ashtu si pothuajse në të gjitha fshatrat e Labërisë e sidomos në ato të Lumit të Vlorës, edhe në Kallarat, takimet e brezave, që janë kthyer në traditë, zhvillohen në çdo vit gjatë periudhës së verës. Takimet e brezave shprehin ndjenja e emocione dhe përcjellin vlera pozitive të brezi i ri për të njohur e respektuar historinë, kulturën dhe traditat e vendlindjes. Këto takime përcjellin mesazhin se, pavarësisht ku ndodhesh, ku punon e banon, brenda e jashtë atdheut, dashuria për vendlindjen, për atdheun e flamurin mbeten të patjetërsueshme. Në këto takime njerëzit vijnë nga çdo skaj i vendit, ku bie në sy ardhja e emigrantëve, e atyre që dashuria për vendlindjen, nostalgjia për origjinën e të parëve merr përmasa edhe më të mëdha. Mblidhen, çmallen me njëri-tjetrin, këndojnë labçe e kërcëjnë valle nën tingujt e muzikës. Gatimet e pijet tradicionale, si mishi i pjekur, byreku, revania, arapashi dhe rakia i bëjnë këto takime edhe më të bukura.

Për herë të parë në takimet e brezave, në atë të organizuar në Kallarat këtë vit më 12 gusht, mori pjesë një këngëtare e madhe e muzikës popullore, kryesisht asaj të Jugut, një këngëtare, muzika e së cilës është e pranishme në çdo gëzim familjar e shoqëror, në çdo udhëtim, në çdo mjedis privat e publik, në çdo sallë e shesh, Maja Aliçkaj. Pjesëmarrja e saj i dha një tjetër përmasë takimit të brezave në Kallarat. Me zërin e saj të fuqishëm, ajo e ngriti peshë sheshin në qendër të fshatit. Për herë të parë pothuajse i gjithë fshati – të moshuar, të rinj e fëmijë – u ngritën fshatçe në valle. Ajo gjatë gjithë këngëve të kënduara me zërin e saj, të ëmbël e plot sharm, u shoqërua nga një grup i vogël fëmijësh që e admironin pa masë Majën dhe e shoqëronin atë gjatë gjithë këngës. Maja, duke mbetur e mahnitur nga kjo pritje e fëmijëve do të shprehej: “Ju jeni të mrekullueshëm, më emocionuat pa masë “I love You”. Shihemi vitin tjetër”. Tani që takimi ka përfunduar dhe Maja është larguar për të vijuar angazhimet e saj artistike të verës, edhe pse kohën e ka të kufizuar, mundëm t’i merrnim asaj intervistën e mëposhtme për gazetën “Shqiptare”.

Si e pritët ftesën për të qenë këngëtare në “Takimin e Brezave” në Kallarat?

Maja: Përshëndetje, së pari, dhe faleminderit që po më krijoni këtë mundësi bashkëbisedimi. Ftesën e kam pritur me shumë kënaqësi, edhe pse realisht kam qenë në një muaj shumë intensiv dhe impenjativ, sa u takon aktiviteteve. Por kjo ftesë më intrigoi shumë, sepse bëhej fjalë për takim brezash dhe për mua organizime të tilla flasin shumë dhe kanë shumë emocion brenda tyre. E



ndaj e pranova me kënaqësi. Gjithsesi, kjo u bë e mundur edhe falë organizimit korrekt, në kohën dhe në mënyrën e duhur.

Çfarë dinit deri në atë moment për Kallarat?

Maja: Në fakt, kisha dëgjuar deri diku për fshatin Kallarat dhe në atë informacion sa kisha, më vinte në memorie si një fshat me traditë që kishte gjurmët e veta në histori. Por nuk kujtoja ndonjë gjë konkrete të madhe. E ndaj, iu futa kërkimit, kryesisht në internet dhe nga aty u njoha me shumë histori, ngjarje e njerëz të shquar nga ky fshat. Kallarati ka nxjerrë njerëz të ndritur e me kontribut në shumë fusha, figura historike, kulturore, artistike, si Heroi i

fituesin e çmimit “Guinness” Saimir Strati, me futbollistin e kombëtares Ledian Memushaj etj. Me një përfaqësim dinjitoz në shumë festivale të Gjirokastrës, me emra të njohur këngëtarësh, si Zeqo Hoxhaj, ku mësova se ishte zëri i këngës aq të njohur popullore “Ç”u këput një këmbë mali”. Evgjëni Jonuzaj me këngën “Djepi ynë burim floriri”, Bilbili i Labërisë, këngëtar i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore Hyso Xhaferaj etj.

Si u ndiet kur shkelët në Kallarat dhe sidomos kur dolët në skenë para një publiku të veçantë?

Maja: Ka qenë një emocion shumë i veçantë dhe shumë shpirtëror. Nuk e mendova aq të bukur, por sa shkela në Kallarat, ende pa zbritur nga makina, nuk më mbeti kohë të mendoja sepse u rrethova që në makinë nga shumë njerëz. Në momentin që zbrita, të gjithë, me shumë dashamirësi, donin të bënin foto e të flisnin me mua. Kanë qenë të jashtëzakonshme ato momente. E më pas, kur dola në skenë, emocionet qenë më të veçanta se në çdo skenë tjetër, pasi atje u ndjeva si në një shtëpi të madhe me oborr gjigant, me shumë familjarë dhe e rrethuar me ngrohtësinë e tyre, ngrohtësi e cila më ka mbetur në mendje dhe më fal një ndjesi dhe energji kaq pozitive sa herë e kujtoj.

Çfarë ju bëri përshtypje nga pjesëmarrja dhe pritja e publikut në përgjithësi?

Maja: E para, më bëri përshtypje mirorganizimi dhe pjesëmarrja e lartë. Me një mori të ftuarish, me një gjallëri të tillë të pjesëmarrësve, është e shumëfishitë adrenalina e duartrokitjeve, është i shumëfishitë emocionin pozitiv që të dërgon publiku, pra çdo gjë shumëfishohet. Nuk e prisja një pjesëmarrje të tillë, referuar dhe faktit që bëhej fjalë për një takim brezash brenda fshatit Kallarat. Por, pavarësisht kësaj, aty kishte pjesëmarrës edhe të fshatrave të tjerë të rrethit dhe shumë personalitete, gjithashtu. Pra, ishte vlerësuar nga të gjithë si një takim brezash që i tejkalonte kufijtë e zakonshëm shpirtëror të brezave të një fshati, të mbledhur nga shumë vende të Shqipërisë ose jashtë saj. E kjo ishte një meritë e padiskutueshme e organizatorëve. Në këtë kontekst, më bëri shumë përshtypje fakti që sheshi ishte mbushur me tavolina të zbuluara, mjedis shumë mikpritës dhe me një ndriçim fantastik. Tavolinat, ashtu siç është zakoni, ishin mbushur me mish të pjekur, me pije freskuese e alkoolike, veçanërisht me rakia, siç e kemi traditën në të Labërisë. Ky ishte me të vërtetë një takim brezash shumë i veçantë, krahasuar me ngjarje të tjera të ngjashme, sepse kishte një superorganizim, një superpjesëmarrje dhe një atmosferë të krijuar prej tyre, ku të gjithë njerëzit ishin në këmbë, të gjithë kërcenin dhe kjo më gëzonte pa masë.

Fëmijët besoj se ishin e veçanta e këtij takimi, gjë të cilën ju e shprehët edhe në skenë para publikut, a mund të thoni diçka më tepër për ata fëmijë, që presin diçka nga e ardhmja e tyre?

Maja: Ooooo, sinqerisht nuk ka fjalë që mund ta përshkruajë atë ndjesi dhe lumturi që kam marrë aty, nga fëmijët. Ishin... si qershia mbi tortë, apo nuk di..., nuk gjej fjalë të përshatshme për të shprehur gjithë atë energji pozitive, gjithë atë dashuri, gjithë atë pasion që pashë tek sytë e tyre, te të kënduarit e tyre bashkë me mua, tek dëshira për të më përqafuluar..., tek gjithçka. Ata ishin talent i gjallë, në mënyrë të veçantë një vajzë e vogël, së cilës për momentin nuk ia mbaj mend emrin, ndonëse më ka shkruar dhe në rrjetet sociale. Ajo ishte një talent i lindur,



Popullit Mumin Selami, luftëtari i epopesë së Topanasë, shkrimtari i dëgjuar Neshat Tozaj, shkrimtari Hiqmet Meçaj, gjuhëtari i dëgjuar prof. dr. Rami Memushaj etj. Por edhe nga fusha e sportit, ky fshat ka pasur sukses të padiskutueshëm me kampionin e Europës në qitje me pistoletë, në mos gaboj Elisabeta Karabollë,

12 GUSHT 2023
“TAKIMI I BREZAVE” NË KALLARAT



Maya!
Mirë se erdhët në
Kallarat!

Ju këndofte shpirti
dhe zemra!



Sponsorizoi firma: 



interpretonte dhe këndonte aq bukur. Të gjithë fëmijët më shoqëronin gjatë këngëve, por ajo spikaste shumë. Mendoj që njeriu lind së bashku me veçoritë e tij, me talentet e tij, e ndaj mendoj se disa nga ata fëmijë aty do shkëlqejnë një ditë në fushën e muzikës, e ndoshta jo vetëm. Uroj që prindërit e tyre ta vënë re këtë cilësi, këtë veçori që kanë, sidomos vajza që përmenda. Ndoshta jeta do t'u buzëqeshë në përgjithësi, por mund të bëhen edhe yje të skenës..., kjo ishte ndjesia ime. Gjithsesi, dua të theksoj se, sigurisht, fëmijët të gjithë i duam, por personalisht kam një dobësi të theksuar e jam nga njerëzit që i dua më shumë, janë adrenalina ime... Tek ata shoh veten time dikur, me të gjitha ëndrrat dhe pasionet, tek ata shoh të ardhmen. Nuk është rastësi që i kam fansat e mi më të zjarrtë dhe është lumturi shumë e madhe që duan këngët e mia, që më duan mua, është një ndjesi reciproke shpirtërore, shumë e pafajshme, si vetë bota e tyre. Gjithashtu, më vjen mirë që duan edhe traditën tonë, folklorin tonë, këngën tonë popullore, si një nga veçoritë që identifikon kombin tonë. Faleminderit prindërve të tyre, që i edukojnë dhe rrisin me kulturën tonë të bukur.

Ndoshta pa e ditur, por ju aty u surprizuat kur e pranishme në këtë takim, jo e ftuar si këngëtare, por si nuse e këtij fshati, ishte edhe këngëtarja e njohur e serenatave korçare, shoqja juaj Ermira Kola (Strati). Si u ndiet kur kënduat së bashku?



Maja: Kjo ishte një tjetër surprizë e bukur që më mbushi shpirtin. Takimi me këngëtarën dhe miken time Mira Kolën. Mira, përveçse është një këngëtare brilante, e shkëlqyer, është edhe mikja ime, bashkë me bashkëshortin e saj. Unë nuk e dija që bashkëshorti i Mirës ishte nga Kallarati me origjinë. E natyrshëm, kur Mira u çua të këndonte



si e ftuar nderi, si nuse e atij fshati, duke sjellë tingujt e serenatave, të cilat janë dashuri edhe për mua, nuk rezistova dot..., u çova dhe e shoqërova. Sinqerisht, u ndjeva shumë mirë, sepse këndova me një artiste të mirëfilltë, nxora mallin me të. Ishte kënaqësi e dyfishtë.

I pranishëm ishte edhe këngëtarja, djali i fshatit Gjergj Leskaj, me të cilin kënduat edhe



labçe, megjithëse ai nuk është profesionist, por është një marrës i mirë i këngës labe dhe kohët e fundit është përpjekur të shfaqet edhe si këngëtar i muzikës popullore me motive të Jugut, ku sapo ka nxjerrë albumin e parë "Jam bir nga Labëria", ç'mendim keni për të, ndoshta edhe për ta inkurajuar?

Maja: Ishte kënaqësi edhe prania e Gjergjit, si djalë Kallarati. Unë mbërrita në festë kur Gjergji ishte duke kënduar, së bashku me grupin e tij. U kënaqa pa masë për atmosferën e krijuar prej tij dhe gjithë grupit. Madje, siç e kemi zakon, kënduam së bashku labçe, më pas, në tavolinën e shtruar, me shumë dashuri. Një djalë që reflektonte shumë dashuri për këngën labe dhe atë popullore. Kur e dashuron diçka shumë, natyrisht

që do ta bësh bukur. E ai ashtu këndonte. I uroj sa më shumë suksese me artin e tij, me këngën e tij, të jetë sa më pranë njerëzve dhe dëshirave të tyre me muzikën e tij e, natyrisht, lart e më lart, sepse s'ka gjë që nuk bëhet, nëse e dëshiron me zemër dhe punon shumë.

8. Ndonjë përshtypje a mendim për mënyrën e organizimit të takimit të brezave?

Maja: E them me bindje të plotë se ishte me të vërtetë një takim brezash shumë i veçantë, krahasuar me veprimtari të tjera të tilla ku kam marrë pjesë. E për këtë, merita kryesore lidhej me superorganizimin që ishte bërë. Përgjithësisht, festat e takimeve të brezave janë të veçanta, sepse shprehin shumë. Por do të veçoja takimin e brezave në Kallarati, sepse ishte i mirorganizuar në gjithçka, në çdo detaj kishte shumë dashuri, ndjesi, respekt dhe energji pozitive. E mira nuk ka fund, por për mendimin tim ishte shumë, shumë bukur. I përgëzoj me zemër organizatorët për këtë.

Moderimi i takimit nga gazetarja e News 24 Anila Ahmetaj a mendoni

se ishte zgjedhje e duhur dhe a ia shtoi vlerat takimit?

Maja: E vërtetë, moderimi i gazetares i dha një tjetër vlerë të shtuar këtij aktiviteti. Ndërthurja aq bukur e fjalëve të saj, me rrjedhën e skenarit, natyrshmëria me të cilën i lidhte ngjarjet, personazhet, të ftuarit dhe ecurinë e skaletës, ishin për t'u admiruar. E dukej sikur edhe me publikun ishte në sintoni. Përgëzimet e mia edhe për gazetaren Anila Ahmetaj.

Dy fjalë për ata që e bënë të mundur ardhjen tuaj, biznesmeni Ylli Breshanaj dhe, më herët, bashkëpunimin që keni pasur me Bujar Muçon, si dy djem të këtij fshati që e duan vendlindjen?

Maja: Një falënderim i veçantë shkon nga ana

ime për djalin kallaratas, biznesmenin e njohur Ylli Breshanaj, i cili bëri të mundur ardhjen time në Kallarati. E këtë e them me shumë respekt, me shumë dashamirësi nga ana ime, për mënyrën e bashkëpunimit që patëm dhe gatishmërinë e tij për të mbështetur praninë time në këtë veprimtari. Një nga djemtë gjithashtu nga Kallarati, është bashkëpunëtori im i parë Bujar Muço dhe miku im natyrisht, i cili para 16 vjetësh, kur unë kam dalë për herë të parë në ekran, ka qenë i pari menaxher që, ndonëse kisha vetëm një muaj në ekran (faleminderit Zotit, gjithë publikut, punës time dhe bashkëpunëtorëve të mi në krijimtarinë e këngëve), ai më fton në koncertin e madh të Vinit të Ri, duke besuar se unë do të bëja atë që realisht u bë, në atë koncert të mrekullueshëm. Për të mos thënë më i bukur. Bujarit i jam mirënjohëse tërë jetën, sepse ka qenë i pari që pati besim të plotë tek unë, për të mbajtur një koncert të atyre përmasave, siç di t'i organizojë veç ai. Sigurisht, nuk ka qenë i vetmi, por ka qenë i pari. E ashtu siç nisi aq bukur, bashkëpunimi ynë vazhdoi shumë i suksesshëm ndër vite e do të vijojë sigurisht. Një përshëndetje shumë e ngrohtë për Bujar Muçon.

Patjetër që si këngëtare keni marrë pjesë në shumë veprimtari në fshatra të ndryshme të Labërisë e më gjerë, si e vlerëson Maja organizimin e "Takimit të Brezave" në Kallarati, a i vlejné këto takime rritjes së ndjenjës së patriotizmit dhe të dashurisë për atdheun dhe vendlindjen, sidomos për brezin e ri?

Maja: Siç e theksova edhe më lart, përgjithësisht, festat e takimeve të brezave janë të veçanta, sepse shprehin shumë ndjesi, emocione dhe përcjellin shumë vlera.

Së pari, tekta sheh alternimin e brezave, njihesh me kontributin e përcjellë nga çdo etapë e historisë së një zone a komuniteti, duke ndërthurur nostalgjinë dhe krenarinë për të kaluarën, duke përjetuar ndjenjat patriotike, sakrificën e brezave të tërë dhe atdhedashurinë e tyre, në periudha historike jo të lehta dhe shumë vendimtare ndoshta për identitetin e zonës apo atë kombëtar.

Së dyti, japin mundësinë t'u gëzohesh zhvillimeve të brezit aktual, atij brezi që në njëfarë mënyre, i di sakrificat e gjyshërve e stërgjyshërve të tij dhe bën përpjekje të mbajë gjallë e të çojë para traditën.

Së treti, por ndoshta më e rëndësishmja, kanë shumë vlerë edukative, duke edukuar dhe mëkuar gjithashtu brezin më të ri, duke nisur qysh nga fëmijët e deri tek të rinjtë që jetojnë kryesisht larg atdheut, me dashurinë dhe respektin për të kaluarën dhe vendin e origjinës. T'i motivojnë e t'u tregojnë atyre konkretisht se, duke ndjekur gjurmët e të parëve, duke mos harruar rrënjët e tyre, ndërtojnë një të ardhme bazuar në vlera, kudo qofshin nesër, në vorbullën dhe intensitetin e globalizimit të jetës.

Me çfarë përshtypjesh u largua Maja nga Kallarati, nga mikpritja, entuziazmi, publiku, organizimi i festës dhe a do të jetë përsëri e pranishme, ashtu siç u premtuat fëmijëve në skenë?

Maja: Në përgjithësi, kryesisht në festa që përkojnë me sezone të ngarkuara me punë, shkoj në koncert, përpiqem të jap gjithçka, jap gjithë shpirtin tim aty për të kënaqur sa më shumë ardashësit pjesëmarrës, përfundoj dhe largohem. Por, sinqerisht, këtë herë, doja që festa të mos mbaronte. Aq shumë më pëlqeu dhe aq mirë u ndjeva, aq energji pozitive kishte gjithçka aty. Ishte e gjitha e veshur me dashuri. Një mikpritje e jashtëzakonshme, një publik që reflektonte entuziazëm, dashuri e pafajshme dhe e pafundme fëminore, një natyrë e mrekullueshme, gatime të mrekullueshme. E sigurisht organizim aq serioz dhe vlerësues. E ndjeva se isha në habitatin tim më të mirë shpirtëror e njerëzor. Siç e thashë dhe aty, doni apo nuk doni, mua këtu do të më keni përsëri. E do të rikthehesha me shumë dëshirë, sa herë të krijohej rasti... (meqë edhe rruga ishte e shtruar, një mrekulli, e besoj do më sjellë vetë makina). Shumë respekt për të gjithë kallaratasit, për të gjithë organizatorët dhe bashkëpunëtorët të cilët bënë të mundur që unë të isha aty, për kryetarin e fshatit gjithashtu. Faleminderit që më zgjodhët mua për këtë takim kaq të rëndësishëm dhe kaq domethënës si Takimi i Brezave.

Faleminderit, gjithashtu, edhe ty për këtë bashkëbisedim kaq të natyrshëm.

Faleminderit Juve, Maja, dhe suksese! Të këndofshë shpirti e zemra kurdoherë!

20 TETOR 1916 – 20 TETOR 2023, 107-VJETORI I ÇELJES SË SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NE KALLARAT

Fshati Kallarati ka historinë e tij shumëvjeçare të qëndresës e të luftës ndaj pushtuesve të huaj, por edhe atë të ndërtimit dhe të lulëzimit të tij në vitet e pasluftës dhe në ditët e sotme të demokracisë. Një pjesë e historisë së tij lidhet ngushtë me kontributin që ka dhënë Shkolla 8-vjeçare që mban emrin e Heroit të Popullit Mumin Selami dhe një brez i tërë mësuesish kallaratas dhe jovendës, të cilët për vite të tëra, me durim, këmbëngulje e profesionalizëm, edukuan, shkolluan dhe u dhanë dijet e para fëmijëve kallaratas, duke i bërë ata të aftë për të konkurruar me shumë sukses në shkollat e mesme e të larta në mbarë vendin.

Arsimi kallaratas zanafillën e tij e ka në mars 1916, në formën e kurseve që zhvilloheshin në shtëpinë e Dushan Seit Jonuzajt në Shesh të Fierit, me mësues patriotin Telo Duro Zhibajn.

Më vonë, për t'iu larguar syve të pushtuesve italianë, që nuk lejonin të bëhej mësim shqip, shkolla që funksiononte në formë kursi, u zhvendos në Povël, në konakët e Maliq Boshit.

Zyrtarisht, shkolla shqipe në Kallarati u çel më 20 tetor 1916 në shtëpinë e Qamil e Zenepe Toçes, e njohur nga Drejtoria e Arsimit Gjirokastrë.

Edhe pse sot ajo, mbas shumë vitesh të funksionuarit si portë e diturisë, ndodhet e mbyllur, ne duhet të krenohemi për atë që ajo bëri për shkollimin e brezit të ri.

SHIFRA DHE FAKTE HISTORIKE PËR ARSIMIN NË KALLARAT

• Mësuesi i parë i shkollës në Kallarati ka qenë Jaho Hodua nga Borshi dhe pak muaj më vonë Musa Sinani (Këlliçi) nga Fterra.

• Nxënësit e parë që u ulën në bankat e shkollës kanë qenë: Ruzhdi Lame, Lilo Habilaj, Izet Bushaj, Azbi Asllani, Hasan Selami, Abaz Shako, Shahin Jonuzaj, Demir Lato, Veledin Rjepaj, Dalan Haxhiu, Ferik Strataj, Shuko Karrabollaj, Hasan Qejvanaj, Hasan Shamo si dhe Hamdi dhe Izet Hasko nga Golemi, të cilët, pas djegies së fshatit të tyre nga grekët më 1913, erdhën në Kallarati.

• Në vitin shkollor 1917–1918 numri i fëmijëve që u ulën në bankat e shkollës, ishte 47. Në këtë vit në shkollën e Kallaratis u emërua mësues Telo Durua dhe 2 vjet më pas Meçan Selami.

• Në shtator 1923 shkolla u mbyll, pasi Kongresi i Arsimit i mbajtur në Tiranë më 22 korrik 1922, në kohën e Qeverisë së Xhafer Ypit, ndalonte çeljen e shkollave ku s'kishte ndërtesë të rregullt shkollore. Qeveria e Fan Nolit, që erdhi në fuqi në qershor 1924, pati jetë të shkurtër, vetëm 6 muaj dhe nuk arriti dot të bënte asgjë për shkollat. Ky vendim apo dhe të tjera shkaqe bënë që në Kallarati për 12 vjet (1923–1935) të mos kishte shkollë.



• Fshatarët kallaratas të udhëhequr nga patriotët Lame Sinani, në atë kohë (1925) sekretar i nënprefekturës së Gusmarit, si dhe Selam Bajrami, Alem Totua, Shamo Meçja e Hodo Kalemi, aty nga viti 1925 ia filluan punës për ndërtimin e një godine për shkollë tek burimi në Morrez.

• Në vitin 1927 godina përfundoi së ndërtuari, megjithatë shkolla nuk u hap. Kërkesa të shumta i dërgonin fshatarët kallaratas Ministrisë së Arsimit të mbretit Zog, por ato binin në vesh të shurdhër.

• Pas përpjekjesh të shumta, qeveria e Zogut, për të hapur shkollën vuri kushtet: "Të kishte një numër të caktuar nxënësish dhe fshati të siguronte vetë godinën e mësimit". Këto kushte u përmbushën dhe shkolla u hap në shtator 1935 dhe funksionoi deri në korrik 1940. Në të u regjistruan edhe moshat të rritura, duke arritur numri i nxënësve në 40–45 vetë. Ndërsa për ndërtesë, falë shpirtit human të hoxhës së fshatit, u përshtat xhamia e fshatit. Mulla Beqir Zhibi tha: "Të hapet shkolla në xhami, pa unë do ta fal xhihanë në qafë të Brodanit."

• Në vjeshtën e vitit 1940 shkolla e ndërpreu veprimtarinë e saj mësimore. Lufta italo-greke dhe më pas pushtimi nazifashist e kthyen Kallaratin në një front luftimi dhe shumica e nxënësve u ngritën në luftë kundër pushtuesve nazistë e fashistë.

• Në shtator të 1945 shkolla u rihap në shtëpinë e Duzë Bajramit, nënës së heroit të Popullit Mumin Selami, pasi shkolla ekzistuese e paraqirimit ishte djegur. Regjistrimi ishte me dëshirë për djem e vajza. Si mësimdhënës u caktua Safet Gjoni nga Fterra.

• Në shtator të 1946 shkolla nisi veprimtarinë

e saj normale në ndërtesën e rregulluar me orendi e mjete të thjeshta mësimore për të zhvilluar orët e mësimit. Jahja Seferi nga Kavaja e Liza Doda nga Shkodra ishin mësuesit e atij viti për t'u pasuar më vonë nga Kozma Llazari e Mërgim Korça.

• Në vitin shkollor 1946–1947 u vu në zbatim vendimi i qeverisë për arsimin fillor të detyrueshëm, që përfshinte djem e vajza që kishin

që në vitin e parë u hapën 7 klasë, duke tërhequr edhe nxënësit kallaratas që ndiqnin mësimet në fshatrat Vranisht e Bolenë si dhe nxënësit e zonave periferike të fshatrave Kuç e Bolenë. Si godinë mësimore u shfrytëzua godina e vjetër e shkollës, duke iu bashkëngjitur një godinë e ndërtuar në 1951 për sallë leximi.

• Në vitin e parë shkollor 1966–1967, për



mbushur moshën 7 vjeç. Pas këtij vendimi, numri i fëmijëve që erdhën në shkollë u rrit ndjeshëm. Në çdo klasë me banka katërvendëshe kishte mbi 20 nxënës.

• Në vitin 1949 ish-nxënësit e shkollës: Enver Gollosaj, Namik Mehmetaj e Bilal Breshanaj ndoqën kursin njëvjeçar për mësues në Vlorë. Ata ishin mësuesit e parë që tërë jetën e tyre ia kushtuan shkollës shqipe, duke dhënë mësim jo vetëm në Kallarati, por edhe në shumë fshatra të tjera të Vlorës. Pas tyre, mbaruan kurse e shkollë dyvjeçare të mësuesisë edhe Hamit Muharremaj, Jazo Davacaj, Shelege Karabollaj, Sami Karabollaj e Servet Gollosaj.

• Në vitet '60 u vu në zbatim ligji për kalimin e arsimit të detyrueshëm nga 7 klasë në 8 klasë. Ishin këto kushtet e krijuara që sollën çeljen e shkollës 8-vjeçare në Kallarati. Në 1 shtator 1966,

herë të parë shkolla krijoi drejtorin më vete me një kolektiv të plotë arsimor, të gjithë me arsim përkatës.

• Pas viteve '70 shkolla e Kallaratis mori fizionominë e saj të vërtetë. Ajo arsimoi të gjithë fëmijët me arsim 8-vjeçar ditën, por edhe në mbrëmje me korrespondencë. Shumë nga nxënësit që mbaronin 8-vjeçaren, kanë mbaruar të mesmen e të lartën.

• Në vitin 1990 niveli arsimor i popullsisë që banonte në fshat ishte me arsim 8-vjeçar 75%, me arsim të mesëm e të lartë 25%; 66,6% e familjeve kishin nga 1 deri në 3 anëtarë me arsim të mesëm ose të lartë.

• Godina e re e shkollës, filloi të ndërtohej në vitin 1985 dhe në shtatorin vitit 1986, në prag të 70-vjetorit të çeljes së shkollës shqipe, në Kallarati nxënësit u ulën në shkollën e tyre të re, të pajisur



100 VJETORI I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË KALLARAT



"Gjuha jonë, sa e mirë, sa e ëmbël, sa e dliurë"

1916



Sponsorizoi: Bako Xhaferaj



Shkolla 8-vjeçare "Mumin Selami"



2016



Ideoi: Besnik Gjombasaj

më së miri me mjete mësimore dhe me laboratorë të kohës.

- Në vitin 1990 në fshat, si kudo në Shqipëri fryu era e “Demokracisë”, era e lirisë së fjalës dhe lirisë së lëvizjes. Shumë kallaras dhe familje u larguan nga fshati në kërkim të një jete më të mirë. Kjo solli jo vetëm “tkurrjen” e fshatit, por edhe rënien e ndjeshme të numrit të fëmijëve në shkollë.

- Në periudhën 90-vjeçare të jetës së saj (1916–2006), shkolla ka funksionuar rregullisht 74 vjet. Në të kanë dhënë mësim 98 mësues e mësuese, nga këta 33 vendës dhe 65 që vinin nga qytete të ndryshme të Shqipërisë: Shkodra, Korça, Kavaja, Vlora, Saranda si dhe nga fshatra e krahina të tjera.

- Niveli i tyre arsimor ka përkuar me kushtet e zhvillimit historik të arsimit në Shqipëri. Kanë qenë me kurse e arsim joprofesional 28, me arsim të plotë pedagogjik 38, me institute dhe universitet 32 mësues.

- Në numrin e madh të mësuesve që kanë dhënë mësim në shkollën tonë kanë qenë bijtë e këtij fshati: Bilal Breshanaj e Hamit Muharremaj që dhanë mësim 25 vjet, ndërsa Violeta Xhaferaj 35 vjet. Ata u dalluan si mësimdhënës me nivel metodiko-shkencor, por edhe si veprimtarë shoqërorë në jetën e fshatit. Po kështu, edhe mësuesit jovendës Feti Mezini, Ali Sadiku, Izmini Begaj e Vesel Habili dhanë mësim në Kallarat rreth 10–15 vjet.

- Në periudhën 1916–2006 në këtë shkollë kanë mësuar 1245 nxënës, nga të cilët 625 kanë mbaruar arsimin e plotë 8-vjeçar. Në vite, shumë nxënës vijuan shkollat e mesme e të larta dhe i shërbyen atdheut në fronte të ndryshme.

- Shkolla e Kallararit pas Çlirimit ka pasur vartësi të ndryshme. Kështu, nga viti 1945 deri më 1949 ka qenë në varësi të rrethit të Gjirokastrës; nga viti 1950 deri 1961 në varësi të rrethit të Vlorës dhe drejtoria e shkollës së Horës, Vranisht; nga viti 1962 deri 1965 po nga Vlora dhe drejtoria e shkollës së Bolenës; nga viti 1966 deri më 2004 me drejtorin më vete dhe varësi nga seksioni i arsimit, Vlorë. Në vitin 2004, me rënien e numrit të nxënësve, drejtoria e shkollës 8-vjeçare suprimohet dhe klasat u bashkuan nga katër në një, si cikli i ulët ashtu edhe cikli i lartë, deri në mbylljen e saj në vitin 2006.

- Drejtorë të shkollës “Mumin Selami” në Kallarat në vite kanë qenë: drejtorin i parë Lumturi Godaj nga Kuçi, nga viti 1966–1970; Çize Xhaferaj 20 vjet nga viti 1970 deri 1990; Lefter Hysaj nag viti 1990 deri 1997; Vojo Davacaj nga viti 1997 deri 2000; Violeta Xhaferaj nga viti 2000 deri 2004 dhe nga 2004 deri në vitin 2006, kur shkolla u mbyll, nga Eglantina Demiraj, por në rolin e përgjegjës, pasi drejtoria qe shkrire në vitin 2004.

- Në vitin 2006, pas 74 vitësh të plota të funksionimit, shkolla për arsye të uljes së numrit të nxënësve u mbyll, me shpresën se një ditë ajo do të rihapet përsëri.

- Nga viti 2006 e në vijim fëmijët kallaras të çdo klase e zhvillojnë mësimin në shkollën e Vranishtit në Horë, ku pushteti vendor ka zgjidhur transportin e tyre me fagon.

Në gusht të vitit 2016 në Kallarat u festua me madhësi 100 vjetori i çeljes së shkollës së parë shqipe, ku morën pjesë shumë bashkëfshatarë. Në këtë ceremoni përkujtimore Bashkia e Himarës me propozim të Shoqatës “Kallarat” nderoi me certifikatë disa nga mësuesit në vite që kanë kontribuar në zhvillimin e arsimit në Kallarat. Me certifikatë me motivacionin “Për kontribut në fushën e mësuesisë dhe të edukimit të brezit të ri” u nderuan mësuesit: Meçan Selami (pas vdekjes), Telo Zhibaj (pas vdekjes), Bilal Breshanaj (pas vdekjes), Namik Mehmetaj (pas vdekjes), Jazo Davacaj (pas vdekjes), Enver Golloshaj, Çize Xhaferaj, Violeta Xhaferaj, Hamit Muharremaj, Lefter Hysaj, Viron Avduli e Nezinete Leskaj (Avduli).

Nga gjiri i kësaj shkolle kanë dalë shumë mësues që patën privilegjin e madh për të shërbyer në vendlindje dhe të mësonin e edukonin fëmijët e fshatit. Një pjesë tjetër e mësuesve kallaras shërbyen anembanë vendit si mësues, drejtorë shkollash e institucionesh arsimore, duke ngritur më lart me punën dhe përkushtimin e tyre nderin dhe lavdinë e Kallararit.

Vlerësim e mirënjohje në këtë 107-vjetor gjithë mësuesve kallaras që shërbyen jo vetëm në Kallarat, po anembanë atdheut!



SEJMEN GJOKOLI

HYSO XHAFERAJ, ZËRI I NDËRPRERË I KËNGËS, NGA CIKLI” VISARE TRASHËGIMIE” I STUDIUESIT TË FOLKLORIT SEJMEN GJOKOLI

“Këngëtarin që bëri zërin e qiellit e përpara kohe u ngjiti dhe vet në qiell.”

Kur bashkëfshatarët e tij, Zeqo Hoxha, me logatjen e burrit të Labërisë, dhe Evgjëni Jonuzi, me ninullën e famshme të gruas labe, do të linin gjurmë të fortë autentike në Kalanë e Gjirokastrës në tetorin e vitin 1983, Hyso Xhaferaj ishte vetëm shtatëmbëdhjetëvjeçar.

Ishte shumë i lidhur, i vështronte në dritë të syrit kur ata interpretonin më vete apo edhe këndonin me të tjerë.

Me Zeqon s’e ndante as dita e as nata, – tregon Festimja, e motra. – Kaq shumë, sa, kur vonohej, mëma do thoshte: – shikoni se ose do të jetë të Zequa ose në Pilor.

Se dhe me piluriotët ishte lidhur që kur ishte fare i ri, kënga ishte sebebi. Ndërkohë, më parë burra të tjerë të vendlindjes së tij patën bërë këngë të madhe.

Djaloshtit të ri që rritej aty në Kallarat mes maleve përfund të cilit shkante Shushica, qysh në vegjëli bashkë me shushurimën e lumit në vesh i tingëllojnë edhe këngët aq të bukura të atyre burrave e grave labëresha.

Vetë i ati, Balil Xhaferaj, shquhej si një marrës me emër dhe duket se ky do të ishte dhe gjeni që do ta hidhte pa kthim në krahët e këngës.

Po edhe këngën nga shtëpia e nisi, me të mëdhenj e të vegjël, grup më vete.

*“Kallarat njëqind shtëpi,
Për vatan qenë të zotë,
Bënë luftë me syngji,
Seç u derdh gjaku me okë...”*

Kur i ati këndonte këtë këngë, edhe gurët e shtëpisë dukej se futeshin në iso.

Në bankat e shkollës, kur këndonin me moshatarët, kishte qejf t’ia merrte por edhe të bënte role të tjera që duan jo pak mjeshtëri.

Ishte koha kur kënga labe këndohej në çdo derë e kur grupet e fshatrave viheshin ballë për ballë në një garim të pandalshëm.

Llambro Hysi, rapsod e organizator i njohur i kësaj ane të Labërisë, do të ndikonte jo pak në formimin e këngëtarit të ardhshëm.

Ai e pikasi, ai e kuptoi se më shumë se marrës një hedhës virtuoz mund të bëhej.

Timbri i zërit, vokali disi i veçantë, vibracionet që arrinte të realizonte, ishin sinjale se një talent i rrallë po i vinte këngës polifonike, madje këngës popullore në përgjithësi.

Kjo mbasi jo pak i pëlqente edhe kënga popullore e muzikuar, ku Vlora qytet shquhej jo pak.

Dashurinë për këngën nuk ia fashitën as vitet e rrokopujës, ato të viteve nëntëdhjetë, ku kënga polifonike, sidomos, do të kalonte provën e madhe të ekzistencës e mbijetesës, por as largimi nga vendlindja drejt kryeqytetit të vendit në moshën njëzetepesëvjeçare.

Ishin vite të vështira dhe vetëm bashkëpunimi me rapsodin e shquar bolenas, Nertesi Asllani, përfshirja për disa kohë në grupin me emrin aq shumë simbolik “Buronjat labe” do të bëhej edhe për këngëtarin e ri kallaras burim shprese dhe një mundësi e madhe për të treguar edhe më tej cilësitë e rralla që i ishin bërë pjesë të shpirtit e të dashurisë së tij.

Në kryeqytetin e vendit do të endej për disa vite mes punës për të mbajtur familjen, por edhe këngës, të cilën do ta këndonte sa herë të bëheshin kokë më kokë me shokët e tjerë nga Labëria.

Njohja me këngëtarin e shquar të këngës popullore Hysni Zela, i cili punonte pranë Ansambllit të Këngëve dhe të Valleve Popullore, do të ishte si një ogur i mirë për t’iu qasur këtij formacioni vokal nga ku për disa vjet do të aktivizohej si i jashtëm pranë këtij institucioni.

Më tej, me kalimin e këtij institucioni kombëtar të këngës e të valles popullore nën drejtimin e Haxhi Dalipit, këtij personaliteti të madh të muzikës e të kulturës vlonjate, duke qenë, veç të tjerash edhe një njohës ekselent i të kënduarit polifonik, Hyso Xhaferi deri në fund të jetës së tij do të atashohet pazgjidhshëmrisht pranë kësaj trupe artistike.

Gramoz Burba, atë kohë përgjegjës i grupit vokal, ku më së shumti në repertor nga më të bukurat mbeten këngët isopolifonike, tregon pikërisht interesimin që bëri për Hyson drejtorin Dalipi.

Ishte një kohë në të cilën edhe vetë kënga polifonike nga trajtimi me nota korale kaloi më shumë drejt asaj burimore.

Këtu Hyso Xhaferi do të kishte vendin e vet të padiskutueshëm, do të ishte në ujërat e veta, kjo falë vokalit të tij tepër specifik, duke arritur pa



asnjë sforcim oktavat më të larta.

Siç tregon Gramoz Burba, atashimi i Hysos pranë grupit vokal të ansambllit koincideoi tamam në kohën që ky formacion elitë i këngës popullore kaloi në një qasje të re interpretimi të këngëve të jugut me iso duke shkuar më pranë “burimit” të tyre.

Krahas kontributit në ansambël, në një tjetër strukturë këngë Hyso Xhaferi do të linte gjurmën e tij prej profesionisti.

Kolegu i tij Gramoz Burba, i cili drejtonte njëherazi edhe formacionin vokal “Zadeja”, tregon për sa e sa këngë të realizuara e mbi të gjitha koncerte të mbajtura sallave e skenave të Europës.

Në jetën e tij koncertore labi nga Kallarat këndoi me mjaft emra të njohur të këngës polifonike burimore e të përpunuar, ku, krahas Nazif Çelës, Përparime Ziflajt, Mehmet Vishes, Nexhip Onjesë, Trifon Golemit etj., do të këndonte edhe me emrat e mëdhenj të lëvrimit të këtij zhanri muzikor, si Hysni Zela e Iriqi Qiriako apo Gramoz Burba e Mimoza Kosturi.

Siç këndoi edhe përtej grupeve të mirëfillta polifonike, atje ku zërin e tij tepër unik e kërkonin këngëtarë të shquar të këngës shqiptare apo kompozitorë, të cilët notat e pentagramit i përziejnë me melosin më të mirë të këngës polifonike.

Por, fatqësisht, kënga e Hyso Xhaferit nuk mund të vazhdonte më tej se 27 shkurti 2022, ditë kur ky korife i këngës labërishte do të ndahej fare i ri nga jeta.

Një këngë e ndërprerë, një zë që nuk do të mundë të shoqërojë më shokët e tij polifonë në skena e në trapeza Labërie.

Një zë i kristaltë që u ngjiti në qiell bashkë me të zotin.

Kur të dy ishin në jetë e në një miqësi të pandarë, Bardi i Bregut e Labërisë Lefter Çipa do të thoshte:


“Hyso Xhaferaj është një bilbil pranë burimi, por është nga ata bilbila që thyen qelqet e qiellit kur lëshon spiralen e tij vokale nëpërmjet fosforinës labe, pra është një unazë trimi me gur xhevahiri. Hysua është një vlerë floriri që tingullin, edhe po ta futësh në dhe, edhe ta futësh në zjarr, edhe ta hedhësh në det të kripur, nuk i ikën ndriçimi e tingëllimi”.

Kur me dhimbje e përcollëm, ca vargje elegjie ma pushtuan zemrën:

*“Pushoi këngën bilbili,
Hyso Xhaferaj si ylli,
Kallarat e kish djalë,
Labëria këngë në ballë,
Iku të ndrigojë me yje,
Mbeti këngësh, Labërie”.*



PSE POETI I VLORËS HIQMET MEÇAJ HESHT BURRËRISHT DHEMBSHUR



NGA ALBERT HABAZAJ

Poeti ynë hesht burrërisht dhembshur
Për qytetin eshtragërryer në furtunë,
Për shtetin tonë liridashës çapaçul i shkullur
Për djalin e tij me universitet, poet e punë.

E... shpirti i tij pashfaqshëm çarë më dysh
Bregua mban sa mban barku i këtij dheu,
Ka të drejtë me pashë të na thotë: "Hiqmoni sysh!"
Tek qartësonte imazhin tonë mjerisht të zbehur.

Ç'qytetarë të përndritëruar jemi të qytetit,
mirë firmë e vulë, por nuk kemi as zë fare,
detachment me frymë drite për vendin e poetit
po s'u bëmë, na hëngrën krokodilët me kollare.

Mua më vjen turp të takoj Hiqmetin në Vlorë,
Dhe malin, dhe lumin sikur mbaj mbi supe,
Djali i tij pastron qytetin nga mbeturinat, kur ca
të gjorë
Të paturpët hanë bukën e ditës me turpe...

Shkruesit e vargjeve shtohen pa rritur si shkurret
Poetët e paktë, si bredha të bukur, të lartë,
Lukunia e shkurreve qelqit digjital turret
S'ka më doganë të merret me shkrimin e artë.



PSE QAJNË GRATË? ANONIME ARABE, SJELLË NË SHQIP



NGA BAJRAM KARABOLLI

- Jo bir, përkundrazi, gratë janë shumë të forta, më të forta se burrat, por, ndryshe nga burrat, ato janë shumë të dhembshura. Dhe dhembshuria ka lot. Kur Zoti krijoi gruan, e bëri atë shumë të veçantë. Supet ia bëri aq të fuqishëm, sa të mbajnë peshën e gjithë botës. I dha asaj fuqi të brendshme që të durojë dhimbjen kur lind fëmijën, por të durojë edhe braktisjen që i bën fëmija i saj kur rritet. I dha asaj fuqi që të vazhdojë përpara kur të tjerët dorëzohen, po ashtu, të kujdeset për familjen e saj, përgjatë sëmundjeve dhe lodhjeve, pa u ankuar. I dha asaj ndjeshmërinë që t'i dojë fëmijët e saj në të gjitha rrethanat, madje edhe kur fëmija i saj e lëndon shumë rëndë. I dha asaj fuqi ta durojë burrin për gabimet që bën ai dhe, duke qenë e formuar prej brinjës së tij (siç thonë) t'ia mbrojtë zemrën atij. I dha asaj mençuri të kuptojë se burri i mirë asnjëherë nuk e lëndon gruan e tij... Dhe, së fundi, Zoti, i dha asaj lotët, që ajo mund t'i përdorë kurdoherë që ka nevojë. Ata janë lotët e saj dhe nuk është nevoja që të japë shpjegime si dhe kur t'i përdorë ata. Biri im, duhet ta dish se bukuria e gruas nuk qëndron në veshjen e saj, as te pamja e fytyrës së saj, apo te mënyra se si i kreh flokët. Bukuria e gruas duhet të shikohet te sytë e saj, sepse ajo është rruga drejt zemrës së saj, vendit ku jeton dashuria dhe dhembshuria.

Djaloshi, pasi dëgjoi përgjigjen, heshti dhe, i habitur me madhësinë e gruas, u zhyt në mendime...

Një djalosh i vogël pyet nënën e tij:

- Pse qan?

- Sepse kam nevojë të qaj, - i thotë ajo.

- Nuk po të kuptoj, - thotë djaloshi i vogël.

Nëna e tij, pasi e përqafon, i thotë:

- Dhe ndoshta kurrë nuk do ta kuptosh!

Më vonë djaloshi i vogël pyet babanë e tij:

- Pse nëna qan pa arsye?

- Të gjitha femrat qajnë pa arsye, qajnë se janë të dobëta, - u përgjigj shkurt dhe pa kujdes i ati.

Djaloshi i vogël, ende nuk e kishte të qartë pse gratë qajnë. Më në fund, pyet një njeri të ditur, i bindur se ai me siguri duhet ta dinte të vërtetën.

- O njeri i ditur, pse gratë qajnë aq lehtë, ngaqë që janë të dobëta?

Dhe njeriu i ditur u përgjigj e tha:



SHQIPËRIA PËR HERË TË DYTË NË FINALET E KAMPIONATIT EUROPIAN 2024

Më në fund, pas një rrugë të gjatë ekipi kombëtar i futbollit nën drejtimin e trajnerit, për herë të dytë, pas kampionatit të vitit 2016, do të jetë në finalet e Kampionatit Europian të futbollit që do të zhvillohen në Gjermani në Qershor 2024. Një sukses më se i merituar i ekipit tonë kombëtar.

Pas hedhjes së shortit dhe përcaktimit të datave të ndeshjeve, UEFA ka zbardhur edhe oraret e sfidave të finaleve të Europianit "Gjermani 2024". Shqipëria do ta nisë rrugëtimin e saj në Europian kundër Italisë, kampiones në fuqi të Europës, më 15 qershor 2024. Sfidat do të luhet në orën 21:00, në stadiumin "BVB Stadion Dortmund". Katër ditë më pas, më datën 19 qershor 2024 kuqezinjët do të luajnë ndeshjen e dytë të Europianit kundër Kroacisë në orën 15:00, në stadiumin "Volksparkstadion Hamburg". Ndeshjen e fundit në Grupin B, Shqipëria do ta luajë ndaj Spanjës më datë 24 qershor 2024 në stadiumin "Düsseldorf Arena" në orën 21:00.

Më poshtë, edhe kalendari i plotë i ndeshjeve të Shqipërisë në finalet e Europianit "Gjermani 2024":

15.06.2024 - Itali vs Shqipëri, "BVB Stadion Dortmund", ora: 21:00

19.06.2024 - Kroaci vs Shqipëri, "Volksparkstadion Hamburg", ora: 15:00

24.06.2024 - Shqipëri vs Spanjë, "Düsseldorf Arena", ora: 21:00

SUKSESE EKIPI KOMBËTAR!



NJIHUNI ME PROJEKTET QË DO TË INVESTOHEN NË KALLARAT NGA BASHKIA E HIMARËS GJATË VITIT 2024



1. Restaurim i urës "Pasarel" në vlerën 2.000.000 lekë.
2. Ura Kallarati në vlerën 5.000.000 lekë.
3. Ndriçimi rrugor në vlerën 8.000.000 lekë.
4. Rikonstruksion i veprës së marrjes dhe i tubacionit kryesor për ujësjellësin e Qafës së Ubavit në vlerën 5.000.000 lekë.

(Marrë nga statusi i Kryetarit të Këshillit Bashkiak të Himarës. z. Dhimitër KAPAJ)

Le të shpresojmë në realizimin e këtyre projekteve, të cilat do të jenë në interes të komunitetit kallaratas.



AFËRDITA BRESHANAJ (HYSAJ), SPONSORI I RADHËS I GAZETËS "KALLARATI"

Afërdita Breshanaj është bijë nga Kallarati dhe e martuar në Bolenë. Ajo ka një dashuri të madhe për vendlindjen, Kallaratin dhe njerëzit e tij. Është aktiviste e shquar e shoqatës dhe e zgjedhur në kryesinë e saj. Ky numër i gazetës "Kallarati" sponsorizohet nga Afërdita Breshanaj. Kryesia e shoqatës "Kallarati" vlerëson kontributin e saj, jo vetëm për gazetën, por në tërësi për dashurinë që shpreh për Kallaratin, të cilën ua përcjell edhe fëmijëve. Faleminderit Afërdita!



Gëzuar Vitin e Ri 2024!

Kryesia e Shoqatës "Kallarati", nëpërmjet kësaj kartoline, urojnë gjithë bashkëfshatarët e saj kudo qofshin, brenda e jashtë vendit, por edhe të gjithë ata, edhe pse jokallaratas, por që diçka shpirtërore, miqësore, shoqërore, gjeografike a lidhje jaku i bashkon me Kallaratin.

"Gëzuar Vitin e Ri 2024! Shëndet, lumturi dhe mbarësi në familjet Tuaja!"

Kryesia e shoqatës "Kallarati"

Ju urojnë:

"Gëzuar Vitin e Ri 2024"! "Shëndet, lumturi dhe mbarësi në familjet Tuaja"!

NDERIM KUJTIMIT TË ZEMËRMIRIT LILO ABAZAJ




NGA QATIP MARA
NORTH CAROLINA USA 23
SHTATOR 2023

Në realitetin e jetës përballemi me një kategori njerëzish, të cilët janë të veçantë, sepse kanë plot vlera e virtyte. Ndoshta janë të rrallë, por nëse i ke prezentë në jetë, do të kuptosh që botës i ka mbetur paksa vlerë fisnikërie e virtytesh sapo i sheh fytyrat e tyre. Një njeri që ka në mendje dhe në shpirt sinqeritetin, është padyshim person i rrallë nga i cili mund të presësh vetëm mirësi, përkushtim e të vërteta. Prezenca e një njeriu të sinqertë të jep shumë shpresë dhe të bën të kuptosh që, edhe pse jemi në një botë ku mbizotëron gënjeshtria e mashtrimi, përsëri sinqeriteti mbetet "mbret i të gjithë kohërave", sepse është i veçantë, i rrallë dhe vetëm gjërat e veçanta mund ta rrëmbejnë zemrën dhe vëmendjen e të gjithëve.

Një njeri i tillë i veçantë ishte edhe i ndjeri, i paharruari Lilo Abazaj, të cilin e kam njohur në rininë time kur sapo kisha filluar punën si mësues në shkollën e Armenit, Vlorë. Isha në moshën 20-vjeçare me vrulle rinore dhe me mungesë përvoja e pjekurie. Krahas punës si mësues, më kishin caktuar të drejtoja organizatën e rinisë të fshatit të bukur Armen, i cili kishte gjallëri me shumë veprimtari artistike-folklorike e sportive. Kur e takova për herë të parë, u emocionova nga biseda dashamirëse atërore që bëri me mua si një prind i dashur. Me një qetësi e urtësi më këshillonte. Në fytyrën e tij të qeshur, në sytë e tij rrezatohej sinqeritet, mirësi e ndershmëri. Ishte shumë i thjeshtë në komunikim me të gjithë. Punonte me përkushtim. Me një durim të veçantë, drejtonte mbledhjet me kooperativistët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të ndryshme. Me urtësi e dashamirësi, kritikonte të metat për të forcuar disiplinën në punë.

Kur punoja mësues në shkollat e qytetit të Selenicës, i ndjeri Lilo Abazaj ishte emëruar drejtues i institucionit të komitetit të partisë të qytetit Selenicë, të cilin e drejtonte me shumë përkushtim e ndershmëri. I ndjeri Lilo Abazaj, me karakterin e tij të fortë e solid, me personalitetin e ndritur nga virtytet më të mira, ishte frymëzues në jetën shoqërore, ekonomike, arsimore e kulturore të qytetit të Selenicës, që në atë kohë kishte rreth 10 mijë banorë, 2 mijë punëtorë në minierën e bitumit, mijëra punonjës në fermën bujqësore-blegtorale e të bimëve mjekësore të Selenicës, dy shkolla 8-vjeçare, shkollë të mesme të përgjithshme, bujqësore, teknikum miniere, dhe disa kopshte parashkolllore, ku jepnin mësim mbi 100 mësues për rreth 2 mijë nxënës.

Zemërmiri Lilo Abazi, me komunikimin e thjeshtë, të butë e të ëmbël, lehtësonte shqetësimet që lindnin gjatë asaj kohe tek qytetarët e familjet selenicë për punësim e strehim. Në atë kohë kishte një dashamirësi të veçantë të rrallë në qytetin e minatorëve. Kjo dashamirësi buronte nga mirësia shpirtërore qytetare selenicë, por ishte ndoshta edhe për shkak të përmasave gjeografike, ku Selenica ishte si një shtëpi e madhe për banorët e vet, që sillshin si pjesëtarë të një familjeje,



gjithashtu të madhe.

I ndjeri Lilo Abazaj ishte i pranishëm jo vetëm në të gjitha institucionet qytetit, por edhe në sektorët e minierës, në ndërmarrjen e furnizimit tregtar, në shkollat e qytetit, në veprimtaritë artistike kulturore si edhe në familjet qytetare. Ishte drejtues korrekt në punë, me integritet moral, me ndërgjegje të lartë, sillej me shumë dashamirësi e me veprime të virtytshme, ishte i motivuar vetëm për të bërë të mira. Ishte inkurajues, përkrahës i përvojës së përparuar në të gjithë sektorët e punëve të ndryshme. I gëzonte shpirti kur shikonte të tjerët të gëzuar. Me fjalën e tij të qetë mbillte dashuri për të gjithë. Shpesh vinte edhe në mbledhjet e kolektivave pedagogjike të shkollave në analizat e punës mësimore-edukative duke bërë diskutime edukative për të forcuar procesin mësimor në çdo orë mësimi.

I ndjeri shpirtmirë Lilo Abazaj ishte edhe një përkrahës i veprimtarive kulturore-artistike të pallatit të kulturës të qytetit minator të Selenicës. Kur organizoheshin festivale, konkurse, takime midis qendrave të punës, interesohej për të ndihmuar drejtuesit e pallatit të kulturës në grumbullimin e amatorëve pjesëmarrës në veprimtaritë kulturore-artistike si edhe për të dhënë shfaqje edhe në qytete të tjera.

E kujtoj me respekt e mirënjohje të ndjerit Lilo Abazaj, sepse ishte shumë dashamirës, burim frymëzimi për mua. Kur punoja për të

krijuar muzeun e qytetit minator të Selenicës, më ofronte ndihmën e tij, duke u interesuar tek organet e pushtetit për fondet financiare për stendat e muzeut të qytetit si dhe më dërgoi që të studioja dokumentet në Akruvin Qendror të Shtetit në Tiranë. Në qëndrimet e tij karakterizohej nga matura, sinqeriteti, ndershmëria, që janë virtytet më të mira njerëzore. Ai mendonte e vepronte me zemër nënë në zgjidhjen e kërkesave e ankesave të qytetarëve, i dëgjonte me vëmendje hallet e shumta dhe këmbëngulte për t'i dhënë të drejtën secilit. Motivi tij ishte zbatimi i drejtësisë për këdo.

I ndjeri Lilo Abazaj ishte një prind shembullor në familje, që, së bashku me bashkëshorten Dylbere Abazaj (Strati), lindën, rritën dhe edukuan katër fëmijë me sjellje shembullore në shkollë e në shoqëri. Djemtë – Ferdinadi, Shkëlqimi, Iliri – dhe vajza Mimoza Abazaj respektonin me shumë dashuri prindërit e tyre të dashur. Prindërit e tyre i edukuan të bëheshin të denjë e të dobishëm për vete, për familjen, shoqërinë e atdheun, Familja e të ndjerit Lilo Abazaj ishte model i jetës familjare në harmoni e kulturë qytetare. Kisha fatin që të banoja me familjen time përballë me hyrjen e familjes së mrekullueshme Lilo Abazaj. Aty njoha më mirë zemrën e madhe të prindit Lilo Abazaj, që jepte shumë dashuri njerëzore. Vajzat e mia u rritën edhe me dashurinë e familjes Dylbere e Lilo Abazaj, të cilët ishin shumë bujarë, humanë e mikpritës. Hynim si në shtëpinë tonë, sepse na

Lilo Abazaj, me karakterin e tij të fortë e solid, me personalitetin e ndritur nga virtytet më të mira, ishte frymëzues në jetën shoqërore, ekonomike, arsimore e kulturore të qytetit të Selenicës, që në atë kohë kishte rreth 10 mijë banorë, 2 mijë punëtorë në minierën e bitumit, mijëra punonjës në fermën bujqësore-blegtorale e të bimëve mjekësore të Selenicës, dy shkolla 8-vjeçare, shkollë të mesme të përgjithshme, bujqësore, teknikum miniere, dhe disa kopshte parashkolllore, ku jepnin mësim mbi 100 mësues për rreth 2 mijë nxënës.

pritnin të gjithë me shumë dashamirësi. Nëna e mrekullueshme Bestrova na priste me shumë dashuri. Ajo e priste me merak e me shumë mall djalin e saj të vetëm, Lilon, kur vonohej nga veprimtaritë e shumta të përditshme. Me dhimbje të madhe i ndjeri Lilo Abazaj përcolli në banesën e fundit nënën e shtrenjtë Bestrovë Abazaj. Kaluan shpejt vitet dhe fëmijët e dashur të kryefamiljarit Lilo Abazaj krijuan familje duke lumturuar prindërit e tyre të shtrenjtë. Emigracioni i hidhur na largoi nga atdheu nëpër botë për një jetë më të mirë, duke na ndarë për së gjalli nga njerëzit tanë të dashur. Ndjeva shumë dhimbje pikëlluese kur mësova se ishte ndarë nga jeta para kohe i miri i më të mirëve, zemërmiri Lilo Abazaj. Ai kishte zemër bamirëse.

Duke shkruar këtë përkujtimore, nderoj me respekt e mirënjohje kujtimin e të ndjerit Lilo Abazaj, i cili u largua nga jeta para kohe, në moshën 66-vjeçare. Sëmundja tinëzare e ndau nga familja e tij e shtrenjtë, që ai e donte aq shumë. Në shtator 2001, 22 vjet më parë, pushoi së rrahuri zemra e njeriut me virtytet më të mira njerëzore, por i miri zemërbardhë Lilo Abazaj është i pavdekshëm e i gjallë në zemrat e fëmijëve Ferdinandi, Shkëlqim, Iliri e Mimoza, të bashkëshortes Dylbere, të motrave të tij të dashura, të nipërve e mbesave, të të afërmeve, të miqësisë e shoqërisë.

Nderime kujtimin të të mirit Lilo Abazaj!



DASHURIA DHE KUJTIMI PËR GJYSHEN TIME, NËNË FATON

NGA MBESA
LONA HOXHAJ

Dashuria për gjyshet nuk ka kufi sa janë gjallë, por edhe kur largohen nga jeta kujtohen edhe me më shumë dashuri, sepse nuk harrohen kollaj përkëdheljet e tyre. Sado në kushte të mira të jesh rritur, gjyshja vlen në ndonjë rast më shumë edhe se vetë nëna, aq më tepër kur jeta jo në çdo rast ka qenë ashtu siç duhej të ishte. Vitet e fëmijërisë kushdo i mban mend dhe dashuria e kujdesi i gjyshes nuk harrohet asnjëherë.

E tillë është edhe Lona Hoxhaj, vajza e Njazi Hoxhajt, e rritur dhe e përkëdhelur që në vogëli nga gjyshja e saj, nënë Fatua, një nënë e urtë dhe e dashur për të gjithë kallaratasit. Një nënë që edhe pse kishte kaluar një jetë plot vuajtje e mundime, por që, me shpirtin e saj human e me humorin e saj të rrallë, të bënte për vete. Një kafe e bërë nga dora e saj dhe e servirur te klubi i "Shtufit" të shijonte më shumë se çdo kafe e bërë në klubet më luksoze dhe e servirur nga kamerierët më të mirë. E tillë ishte Nënë Fatua.

Në përvjetorin e tetëmbëdhjetë të ndarjes nga jeta, mbesa e saj Lona Hoxhaj për gazetën Kallarati na dërgon dedikimin e mëposhtëm.

"Edhe pse vitet kalojnë, gjyshja ime e mirë më mungon shumë. Të kujtoj me mall kujdesin, durimin dhe qetësinë tënde, që na mbajte rreth vetes mua dhe fëmijët e xhaxhit. Me dashuri prisje edhe fëmijët e hallave. Avllia jote ishte plot me fëmijë dhe moshatarë që gjenin ngrohtësi nga fjala jote. Ai Shtufi i lartë plotë me kujtime, ku mbysje hallat e tua duke pirë kafe me ata që të respektonin. Të kujtoj sot: fëmijët e tu, nipër dhe mbesa.

Qoftë i paharruar kujtimi yt, o gjyshja ime e mirë nënë Fato!"

Edhe kryesia e Shoqatës Kallarati, në këtë përvjetor kujton me respekt e mirënjohje këtë grua, këtë nënë e gjyshe të veçantë. Qoftë i paharruar kujtimi i saj!

Në kujtesë të nënë Fatos, këtij dedikimi i bashkëngjirim edhe poezinë e poetit të Labërisë, Nertesit Asllanit "NËNË ME ZEMËR TË MADHE", kushtuar Nënë Fatos, poezi që përmbledh shumë bukur figurën e kësaj nëne labe.



NËNË ME ZEMËR TË MADHE

*Shtëpisë së vjetër i kërcasin trarët
Dhe muret dalëngadalë po vënë bark
Se nënë Fatua s'duket më te shkallët
Dhe bari zë e rritet rreth e qark.*

*Oxhak' i lashtë nxiu e mbeti ftohur
Dhe s'duket tani tymi si turbinë
Mungon ajo që e mbante ngrohur
Dhe prenë vardharin gjithë ata që vinë.*

*Përpara derës arra rri menduar
Dhe shtufi boshatisur e i vrarë
Rreth e rrotull heshtja është shtruar
Dhe s'duken me të rinj e moshatarë*

*Nënë Fatua me zemër të madhe
Kurrë s'u lodh e s'u ankua kurrë
Luaneshë qëndroi përmbi halle
Se mbeti vetë grua, vetë burrë.*

*Kafeja jote e ëmbël kishte duk
Ndaj dera mbetej hapur dil e hyr
Dhe shtruar përmbi vatër ajo bukë
Më e ëmbla bukë që shtroi kjo nënë e mirë.*

*Dhe vitet fluturuan pa kuptuar
Një ditë vere papritur mbylli sytë
Dhe mbeti zjarri ndezur, sofrë shtruar
Dhe mbeti prapa shembëllimi yt.*

*Iku Fato Hoxhaj me lezete
Lodhur nga mundimi shumë i gjatë
Cicëronin zogjtë nëpër rrepe
Dhe lulët e verës derdhën mjaltë*

*Mbeti emri, po ti s'dukesh më
majë atij shtufi mbi xhade
S'ndihet asnjë hap e asnjë zë
Dhe te oxhaku s'piqet më kafe...*

KUJTOJMË FIQIRETE RJEPAJ NË 24-VJETORIN E NDARJES NGA JETA



IN MEMORIAM,
nga Violeta Xhaferaj
për kunatën e saj
Fiqirete RJEPAJ

E dashur Fiqo,

Sot u bënë 24 vjet që TI je ndarë nga kjo jetë, më 16 Korrik 1999, në moshën 53-vjeçare. E kë nuk pikëllove ti, kunata ime!? Hidhërove e pikëllove nënën tënde, motrat e vëllezërit e Tu, bashkëshortin tënd (Nekiun), vajzën (Edlirën) dhe djemtë (Yllin, Arianitin e Hektorin), por hidhërove pa masë dhe vjehrrën tënde (Velidenë) e kunatën e kunetërit e Tu.

Ti, Fiqua jonë, ishe rritur me ne, sepse erdhe në Rjepaj në një moshë të re. Erdhe nga Gjirokastra për herë të parë me fustan të bardhë në Kallarat në moshën 18-vjeçare. U rrite me ne, punove me ne, gëzove me ne, por nuk qe thënë që të ishe gjithmonë me ne, se jeta t'u këput në mes, në kohën më të mirë që ti do gëzoje me fëmijët e tu, me nipërit e mbesat e tua.

Ike dhe le të pikëlluar e të helmuar bashkëshortin tënd, fëmijët e Tu dhe të gjithë ata që të kishin njohur.

Fiqua jonë, ike aksidentalisht në rrugë, ishe nisur të vije në shtëpi dhe fatkeqësisht të sollën të tjerët!!!

Ishe vajzë e mrekullueshme e më vonë grua zonjë. Ashtu, e bukur, e qeshur, punëtore, nikoqire e mirë, gojëmjaltë dhe e dashur, do të mbahesh mend nga të gjithë ata që të kanë njohur, që jetuan e punuan me Ty, kunata ime e shtrenjtë.

Ike shumë shpejt, nuk gëzove jetën Tënde e nuk gëzove fëmijët e Tu (17 vjeç e le Hektorin), nuk i shijove arritjet e tyre.

Mezi i shkruaj këta rreshta, kunata e motra ime, zemra nuk ma thotë, duart më dridhen, sepse nuk e besoj që ti je ndarë nga ne, por të detyrohem, ndoshta dhe vonë, por Ti je nga ato që mirëkupton..., sepse të kanë ardhur pranë njerëz të afërm të familjes TËNDE, të ka ardhur para kohe vëllai Agroni.

Rri e qetë, Fiqua jonë, të gjithë të familjes tënde i ke shumë mirë.

Gjithmonë do të kujtohesh me dhimbje, me respekt, dashuri e mirënjohje, FIQUA jonë.

Në këtë ditë përkujtimore edhe kryesia e Shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes Rjepaj vlerësim e mirënjohje. Qoftë i paharruar kujtimi i saj!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA DHËNDRI KALLARATAS,
NIKOLLË RAKIP SHKURTAJ

Më 20 korrik 2023 u nda nga jeta Nikollë Shkurtaaj, bashkëshorti i Liri Shkurtaaj (Qejvani), babai i Artanit, Albanit e Bledar Shkurtaaj, kunati i Maksimit, Natashës, Vjollcës e Lavdosht Qejvanit. Nikolla (Nikua) lindi në Vranisht të Vlorës më 6 dhjetor 1940, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare nga prindërit Rakip dhe Bejlere. Nikua u martua me bijën nga Kallarat Liri Qejvani në vitin 1968, me të cilën lindën tre djemtë: Artanin, Albanin dhe Bledarin. Nikua pati përfunduar me sukses një sërë shkollash të arsimit civil e ushtarak dhe shërbeu me përkushtim e devotshmëri një kohë të gjatë në radhët e Forcave të Armatosura: në Flotën Detare, në Korpusin e Fierit e deri në atë të Burrelit. Kudo ku punoi e jetoi deri sa doli në pension, Nikua së bashku me Lirinë manifestuan vlerat më të larta intelektuale, njerëzore dhe familjare. Nikua, edhe pse ishte vranishnjot nga origjina, ishte po aq edhe kallaratat, pasi ai së bashku me Lirinë do ishte i pranishëm në çdo gëzim, hidhërim e festë të Kallararit. Nikua ishte një kuadër i zoti, një prind i shkëlqyer, një bashkëshort i denjë, një gjysh i dashur



dhe një veprimtar shoqëror i rrallë. Ndarja nga jeta e Nikos është një humbje për familjen, për të afërmit, por edhe për ne kallaratat. Kryesia e Shoqatës Kallaratit i shpreh familjes Shkurtaaj dhe Qejvani ngushëllimet më të thella për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur! Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA
JETA SIRMË BESHU
KONGJONI (HITAJ)

Më 3 gusht 2023 në Vlorë u nda nga jeta në moshën 89-vjeçare Sirmë Beshu Kongjoni (Hitaj). Sirmë lindi në Kallarat më 6 Mars 1934 në një familje me ndjenja patriotike e atdhetare, nga prindërit Beshu e Shaze Hitaj. Ajo u martua në Vranisht me ushtarakun Lame Kongjoni, me të cilin lindën dy djem dhe një vajzë. Për shumë vite ata jetuan në Shkodër, duke lënë një emër të mirë në komunitetin shkodran. Pas viteve '90, pas ndarjes nga jeta të bashkëshortit, Lames, ajo u vendos në Vlorë, pranë njerëzve të saj. Nënë Sirmë ishte një nënë e mrekullueshme, një gjyshe e dashur. Ajo tregonte dashuri të madhe për vendlindjen, Kallaratin, dhe për njerëzit e tij. Vitet e fundit të pleqërisë ajo përballoi me dhimbje ndarjen e parakohshme nga jeta të dy djemve të saj. Ajo u largua nga jeta duke lënë vajzën e vetme në Shkodër, nipër e mbesa. Kryesia e Shoqatës Kallaratit i shpreh familjes, vajzës, nuseve të djemve, të afërmeve dhe fisit Kongjoni e Hitaj ngushëllime të thella e të sinqerta për ndarjen e njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i saj! U prehtë në paqe!



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
NAZMI HALIL ABAZAJ

Më 7 shtator 2023 u nda nga jeta në Itali në moshën 85-vjeçare, kallaratasi Nazmi Abazaj, bashkëshorti i Behije Abazaj (Hasamataj), babai i dy djemve - Adrianit e Armandos - dhe i vajzës, Suzanës, vëllai i Arshi e Haxhi Abazaj (ndarë nga jeta). Nazmiu lindi në Kallarat më 12 shkurt 1938, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare nga prindërit Halil dhe Fatime Abazaj. Nazmiu, ashtu si gjithë fëmijët kallaratat të atij brezi, u rrit mes vuajtjesh e vështirësish ekonomike, vështirësi edhe si rezultat i pushtimit të vendit nga pushtuesit fashistë e nazistë gjatë Luftës së Dytë Botërore, por me ndjenjën e urrejtjes e të luftës ndaj armikut, edhe pse moshë e tij ishte e vogël. Pas arsimimit dhe krijimit të familjes, me Behije Hasamatajn, Nazmiu për një kohë të gjatë, derisa doli në pension në vitin 1993, shërbeu me përkushtim e devotshmëri si ushtarak në Marinën Luftarake Detare në ishullin e Sazanit.



Vitet e fundit të jetës i kaloi pranë fëmijëve, nipërve e mbesave në Itali, por me dashurinë dhe vëmendjen ndaj vendlindjes, Kallararit dhe Vlorës, ku jetoi familjarisht një kohë të gjatë. Nazmiu ishte një bashkëshort i denjë, një prind i mrekullueshëm e një gjysh i dashur, por edhe një shok i veçantë i komunitetit ushtarak të Detarisë, ku kaloi një pjesë të konsiderueshme të jetës. Sëmundja e kohëve të fundit e ndau atë nga familja, miqtë e shokët e tij. Kryesia e shoqatës Kallaratit i shpreh bashkëshortes, fëmijëve, nipërve e mbesave dhe gjithë vëllazërisë Abazaj, ngushëllimet më të thella e të sinqerta për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur.

Vlerësim e mirënjohje për kontributin e tij si ushtarak në shërbim të mbrojtjes së Atdheut, në një nga repartet më të vështira të Forcës Detare, atë në ishullin e Sazanit. Mirënjohje për kontributin ndaj vendlindjes dhe përcjelljes te brezi i ri të ndjenjës së dashurisë për vendlindjen, Kallaratin. Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!

IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA
BEXHET SHAHIN
JONUZAJ

Më 30 tetor 2023 u nda nga jeta në moshën 84-vjeçare Bexhet Shahin Jonuzaj, bashkëshorti i Selvisë, vëllai i Shametit (ndarë nga jeta), Platonit, Verës (ndarë nga jeta), Mimozës, babai i Elisabetës, Fatosit, Teutës, Vullnetit, Rolandit, Altinit, Albanës, Argjiros dhe Elvedinës. Bexheti lindi në Kallarat më 23 qershor 1939 në një familje me ndjenja të larta patriotike e atdhetare nga prindërit Shahin e Taibe Jonuzaj. Bexheti u martua me Selvinë më 27 maj 1962, me të cilën lindën,



rritën dhe edukuan 9 fëmijët e tyre me ndjenjën e dashurisë për njëri-tjetrin dhe shoqërinë. Bexheti punoi gjithë jetën me ndershmëri e përkushtim në sektorin e ndërtimit. Ai ishte njeri i ditur, i dashur, i shoqërisë dhe me kontribute të vlerësueshme ndaj vendlindjes dhe shoqatës Kallaratit. Me ndarjen nga jeta të tij, familja dhe të afërmit humbën njeriun e tyre të dashur, Kallaratit humbi një bir të denjë të tij. Kryesia e shoqatës Kallaratit i shpreh familjes dhe të afërmeve ngushëllimet më të thella e të sinqerta. Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!

NDAHET NGA JETA GRUAJA SHEKULLORE, PARTIZANIA E BRIGADËS SË TETË SULMUESE, SARTË GOLLOSHAJ (RUÇAJ)

Më 17 nëntor 2023 u nda nga jeta një nga gratë më të moshuara të Kallaratis, e cila kapërceu shekullin, Sartë Xhebro Ruçaj (Gollosaj). Sarta lindi në Kallarati më 20 maj 1923 në një familje me ndjenja të theksuara atdhetare nga Xhebro e Nure Gollosaj, në vëllezërinë e dëshmorit Ferik Gollosaj. Në moshën 17-vjeçare Sarta mbeti jetime. Me vdekjen e s'ëmës i ranë mbi shpinë tërë punët e shtëpisë dhe kujdesi për motrat e vëllezërit më të vegjël. Këto e të tjera halle e mësuan të përballonte vështirësitë e jetës. Fati bëri që të martohej me Ormën Boron nga Ribajt e Kallaratis, të njohur e të dëgjuar për mençuri e trimëri. Por lumturia e saj nuk zgjati shumë. Ormëni, si shumë bashkëfshatarë të tjerë kallaratas, u përfshi në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, fillimisht në çetën "Mumin Selami" e më vonë në radhët e Brigadës së 8-të Sulmuese. Më 8 qershor 1944, në luftime të përgjakshme me armikun në Sopik të Gjirokastrës, Ormëni plagoset rëndë dhe humb jetën nga plagët e marra. Lajmi i kobshëm erdhi në Kallarati. Dhembja pushtoi tërë familjen. Më shumë këtë dhimbje e ndjeu Sarta. Jetimja nuk pati fat. I digjej shpirti e i therthe zemra për bashkëshortin, që iu pre jeta në mes. Vendosi t'i merrte hakun të shoqit. Dhimbjen e ktheu në forcë. Mbi fanatizmin vuri patriotizmin. Një mëngjes mori nënë Takdiren (vjezhrrën) për dore, e uli para shtëpisë e filloi të vajtonte:

*Hajde të vajtojmë, nënë,
u shkulën dy lisa me rrënjë,
xha Feriku me Ormënë.
Do bëj si suan që kam,
partizane unë do dal,
hakun e tyre do marr.*

Dhe kështu bëri. U përshëndet me të afërmit e bashkëfshatarët dhe u rreshtua në vend të Ormënit në radhët e Brigadës së 8-të Sulmuese. Kërkoj pushkën e të shoqit dhe me të luftoi trimërisht kundër pushtuesve nazistë në të gjitha luftimet



që bëri kjo Brigadë deri në Vishegrad. Sa herë që godiste mbi armiqtë, mbas çdo shkrepjeje të pushkës, thoshte: "Hakmarrje për Ormënin e Ferikun". Akti i saj patriotik pati jehonë në fshat

në krahinë dhe shërbeu për nxitur më tej urrejtjen ndaj pushtuesve nazistë, duke u quajtur me të drejtë një "Shote Galicë" e dytë. Mbas lufte Sarta njihet e martohet me Selam Ruçajn, edhe ky pjesëmarrës



në luftë në Brigadën e 5-të Sulmuese. Me të lindën, rritën, edukuan e arsimuan me sakrificë e punë të ndershme shtatë fëmijët e tyre: Nuriun, Vasillaqin, Lavdien, Floretën, Vojsavën, Abazin dhe Jaziun. Të dy punuan me përkushtim e devotshmëri, Selami ushtarak dhe Sarta kuzhinierë e punë të tjera. Sarta jetoi gjatë, kapërceu edhe shekullin, duke qenë një gjyshe e stërgjyshe e dashur dhe e nderuar për të gjithë. Njerëz të tillë meritojnë respekt e mirënjohje. Sarta u nda nga jeta më 17 nëntor në fshatin Fitore të Vlorës dhe u përcoll për në banesën e përjetshme me nderimet që i takonin një gruaje të tillë veterane e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Kryesia e shoqatës "Kallarati" i shpreh familjes Ruçaj, fëmijëve, nipërve e mbesave, por edhe vëllazërisë Gollosaj, ngushëllimet më të sinqerta. Vlerësim e mirënjohje për kontributin e saj në luftë dhe në punë! Qoftë i paharruar kujtimi i saj! U prehtë në paqe!

IN MEMORIAM

Më 7 dhjetor 2023 në Tiranë u nda nga jeta në moshën 89-vjeçare një nga anëtarët e saj më të devotshëm, ish-ushtaraku Mevlan Habilaj. Mevlani lindi në Kallarati më 3 dhjetor 1934, në një familje me ndjenja të theksuara patriotike dhe atdhetare nga prindërit Bedo e Fatime Habilaj. Si gjithë fëmijët e asaj periudhe u rrit mes vuajtjesh e vështirësish të mëdha ekonomike, por me dëshirën e madhe për arsim, dije dhe kulturë. Shkollën fillore e kreu në Kallarati në vitet 1945-1947, 7-vjeçaren në Kuç në vitet 1947-1950 dhe të mesme në Vlorë në 1950-1953. Në vitet e rinisë së tij ka qenë aktivist i organizatës së rinisë së fshatit dhe ka marrë pjesë si vullnetar në shumë aksione për rindërtimin e vendit, si në hekurudhën e Peqin-Elbasan, në ndërtimin e fabrikës së Orizit në Vlorë etj. Më vonë, në vitet 1953-1956 kreu me sukses Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, në degën e Artilerisë Kundërajrore. Gjithashtu, pati kryer edhe Shkollën e Lartë për Shkenca Politike në vitet 1964-1967 në Tiranë, një vit kurs pasuniversitar për Filozofi dhe Ekonomi Politike në vitin 1977, si dhe shumë kurse të shkurtra për specializim ushtarak e politik. Nga viti 1956, që u titullua oficer, dhe deri në vitin 1990, kur doli në pension, për gati 50 vjet, Mevlani shërbeu me përkushtim e devotshmëri në radhët e ushtrisë në një sërë detyrash të rëndësishme në sektorin ushtarak e politik deri në nivele të

NDAHET NGA JETA MEVLAN BEDO HABILAJ



larta drejtuese. Mevlani u martua me Zilon, me të cilën lindën, rritën, edukuan dhe arsimuan katër vajza: Adrianën, Suzanën, Linditën dhe Mirelën. Mevlani ka qenë i apasionuar në shkrime, duke qenë korrespondent i rregullt i gazetës "Luftëtari" dhe i revistës ushtarake "10 Korriku" dhe në organe të tjera të shtypit të kohës. Pas daljes në pension, ka kryer shumë detyra shoqërore në lagje, anëtar i Komitetit të Përgjithshëm të Veteranëve të Tiranës etj. Mevlani kishte një dashuri të madhe për vendlindjen, ishte zgjedhur anëtar i kryesisë së Shoqatës "Kallarati" dhe kontribuonte me shkrime në gazetën e saj, por edhe në gazetën "Bolena" dhe "Labëria". Mevlani ishte mishërim i njeriut të urtë, të ditur e të dashur me të gjithë. Ai ishte një bashkëshort, një prind dhe një gjysh i shkëlqyer. Për punën si ushtarak, por edhe si aktivist shoqëror mbante një sërë dekoratash e medaljesh të marra gjatë karrierës ushtarake gati 50-vjeçare. Me vdekjen e tij familja humbi njeriun e tyre të dashur, por edhe Kallarati një burrë të denjë të tij. Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh ngushëllimet më të thella bashkëshortes, vajzave, nipërve e mbesave dhe vëllazërisë Habilaj për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të dashur. Qoftë i paharruar kujtimi i tij! U prehtë në paqe!


PIKTORI FATOS RIBAJ: “KALLARATI, FRYMËZIMI IM I PARË PËR T’U BËRË PIKTOR”

Piktori, Fatos Caush Ribaj, me origjinë nga Kallarati, lindi në Vlorë më 25 shkurt 1969 dhe aktualisht prej gati 30 vjetësh, si shumë shqiptarë, jeton në Itali. Fëmijërinë dhe periudhën e adoleshencës i kaloi në Berat, pasi i ati ishte ushtarak. Pasioni ndaj pikturës bëri që të kryejë shkollën e mesme në Liceun Artistik në Berat dhe mandej Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, dega pikturë. Në Itali për një periudhë të vogël kohe kreu punë nga më të ndryshmet e të vështirat, derisa ra në kontakt me artistë e piktorë italianë e filloi të ushtrojë profesionin e ëndërruar të piktorit. Fatosi tregon se piktura e parë publike e tij, e cila i dha një shtysë të fortë për të vijuar profesionin e piktorit, ishte ajo e gjyshes së tij, Pajame Ribaj, paraqitur për konkurrim në Institutin e Lartë të Arteve, e cila u vlerësua shumë për nivelin e lartë artistik.

Ndër stilet më të pëlqyera të pikturës për të janë: portreti, peizazhi dhe kompozicioni, por kohët e fundit ka filluar të eksperimentojë me mjaft sukses pikturën abstrakte, duke mos lenë mënjanë dhe peizazhin.

Ka marrë pjesë në disa ekspozita kolektive e individuale në Itali, Francë dhe Austri, ku ka fituar shumë çmime si: “Raffaello Sazio” në Firenze, “Giorgio Vassari” në Grosseto, “Michelangelo Buonaroti” në Romë, “Cristoforo Colombo” në Gjenovë e shumë çmime të tjera. Pikturat e tij sot ndodhen në galeritë më të njohura të Italisë, si: galeria “Orler” në Venecie, galeria “Malinpensa” në Torino dhe galeria “Meringi” në Gjenovë dhe disa prej tyre dhe në Amerikë.

Edhe pse familjarisht i vendosur në Itali, Fatosi nuk e harron kurrë Kallaratën, Vlorën e Beratin dhe është i gatshëm të kontribuojë, qoftë me hapjen e një ekspozite personale në Tiranë dhe Vlorë, ndërsa për Kallaratën, vendlindjen e të atit, Caushit, që, sa ishte gjallë e deshi aq shumë, pikësynimi i tij është të pikturojë “Fshatin e Djegur”, siç ka qenë para djegies nga andartët grekë më 1914, me shtëpitë e tij karakteristike e të bukura, të ndërtuara në pllajë, rrëzë Bogonicës.






Ja si shprehet Fatosi: “Kallarati me të vërtetë është një fshat i vogël, por me vlera të mëdha njerëzore, patriotike dhe historike. Ndikimet e mia për të pikturuar i kam që në vegjëlinë time, kur sodisja malet dhe bregoret e Kallararit dhe të gjithë zonës sonë të lumit të Shumicës. Jam krenar që gjaku im e ka prejardhjen nga ai vend fisnik. Atje në Kallarati, në kohën e pushimeve të shkollës, u burrërova dhe u forcova qoftë me vështirësitë e qoftë me fisnikërinë e atyre njerëzve të mirë dhe të dashur, të cilat më shërbyen në jetën e vështirë të kurbetit, prandaj, sa herë vij në Shqipëri, patjetër do të kthehem në Kallarati për t’u çmallur dhe për të kujtuar vitet e mia të vegjëlisë”.



FESTIVALI DORR

Ec ngado
KALLARATIN
mos e harro!



Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Anëtarë:
Prof. dr. Rami MEMUSHAJ,
Hiqmet MEÇAJ,
Fatmir MATAJ,

Çize XHAFERAJ,
Eleni MEMUSHAJ,
Besnik GJONBRATAJ,
Riza MEMUSHAJ,
Selo QEJVANI.

REDAKTOR/KORREKTOR:
PROF. DR. Rami MEMUSHAJ

Graphic Designer:
Afërdita Hysaj